



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit me karakter Profesional në  
“Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente”  
Universiteti “Metropolitan Tirana”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Irma SHYLE

Dr. Olta NEXHIPI

**Dhjetor/2020**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Për Programin e studimit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe**  
**Evente"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Metropolitan Tirana"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Administrative (Fakulteti i Ekonomisë)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi i studimit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR NR. 413 datë 13.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	Nuk ka (akreditohet për herë të parë)
8	Cikli i studimit:	-
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
13.1	• Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	JO
13.2	• Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	JO
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	22 pedagogë nga ku <b>13 PAE</b> dhe <b>9 PAK</b> Mbulimi i programit në ngarkesë është 68% PAE / 32% PAK
16	Numri i studentëve (për dy vite):	36
17	Komente / të tjera:	-

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti "Metropolitan Tirana" u licencua me vendim Nr. 357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private e Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana".

Pas miratimit të statutit me UMASR Nr. 611, date 28.09.2018, institucioni është riorganizuar nga SHPAL në Universitet me UMASR Nr. 195, datë 01.04.2019. Universiteti "Metropolitan Tirana" është akredituar me VBA nr. 45 date 05.07.2019, deri me datë 14.12.2022.

Fakulteti i Ekonomisë është një nga tre njësitë kryesore të Universitetit "Metropolitan Tirana". Ky fakultet synon të arrijë standarde akademike dhe pajisjen e studenteve me dije dhe njohuri praktike të cilat do ti ndihmojnë ata të përballen me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

Programi me karakter profesional 2 vjeçar i studimit "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" është hapur me urdhrin nr. 413, datë 13.07.2018 për "Hapjen e programit të studimit me karakter profesional në "Menaxhim në turizëm, hoteleri dhe evente" të SHPAL "Universiteti Metropolitan Tirana". Ky programi është aktivizuar për herë të parë në vitin akademik 2018-2019 dhe është atashuar pranë departamentit të Shkencave të Administrimit në Fakultetin e Ekonomisë.

Gjatë vitit akademik 2019-2020 departamenti i Shkencave të Administrimit ka patur në përbërjen e tij nëntë (9) anëtar të personelit akademik me kohë të plotë dhe njëzet e dy (22) anëtarë me kohë të pjesëshme, ky personel është angazhuar në procesin e formimit të studentëve të programit "Menaxhim në turizëm, hoteleri dhe evente" duke u përpjekur të përgatisë për tregun profesionistë në ofrimin e shërbimit të turizmit, hotelierisë dhe eventeve.

Gjatë viteteve që ky program ka qënë aktiv, trendi i regjistrimeve në të ka qënë rritës, edhe pse ky nuk mund të merret si një indikator i mirëqënë për faktin se periudha që programi është aktiv është periudhë e shkurtër. Pavarësisht përkushtimit të lektorëve dhe institucionit duhet të themi se është i nevojshëm krijimi i një strategjie dhe përmirësimi i elementëve të rëndësishëm të kurrikulës me qëllim formimin e duhur të studentëve dhe forcimin e tyre në fushën praktike.

Ky program studimi ofrohet në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Studentët e këtij programi kanë mundësinë të zhvillojnë leksionet në ambiente komode, për sa i përket zhvillimit të leksionit, si dhe kanë akses në facilitete si biblioteka, laborator, etj.

Universiteti Metropolitan Tirana është i përfshirë në projekte si dhe është në tratativa për të lidhur marrëveshje me kompani të mëdha në fushën e turizmit, gjë kjo e cila do të lehtësojë procesin e praktikave të studentëve. Specifikojmë se studenti në këtë program studimi është në qëndër të vëmëndjes si për departamentin dhe për institucionin që e ofron këtë program. Lektorët parqiten të angazhuar dhe ofrojnë profesionalizën dhe transparencë në punën e tyre.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017 ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit. Bazuar në Urdhërin, për akreditimin e programit të studimit me karakter profesional “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente”. Grupi i vlerësimit përbëhet nga

- Dr.Irma SHYLE
- Dr. Olta NEXHIPI

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit. Ky dokumentacion pati disa mangësi të cilat u vunë në dispozicion të grupit të vlerësimit përgjatë dhe pas vizitës së ekspertëve.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ekspertët përgatitën draft raportin dhe hartuan një gamë pyetjesh të cilat ndihmuan në qartësimin e disa pikave dhe problematikave të këtij raporti. Gjatë vizitës së kryer në datat 28-29 Shtator 2020 u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Metropolitan Tirana. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. Në fund të raportit ekspertët kanë listuar pikat e dobëta dhe të forta të këtij programi si dhe kanë hartuar një sërë rekomandimesh me qëllim përmirësimin e programit, në të mirë të studentëve, të Universitetit dhe të tregut të punës në të cilin këta studentë do të përfshihen.

Më datë 06.11.2020, përmes sistemit AMS, dhe me shkresë zyrtare Nr. 18/22 Prot., datë 06.11.2020, Universiteti “Metropolitan Tirana” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Me datë 19.11.2020, IAL përcjell komentet për këtë draft, nëpërmjet AMS dhe zyrtarisht me shkresë Nr. 136/1 Prot.

GVJ, pasi u njoh me komentet e UV sqaron si më poshtë:

- I. GVJ\_Fusha I\_St 1.1 Kriteri 6:** *GVJ konstaton se në evidenca nuk paraqiten komunikime zyrtare me punëdhënësit të fushës dhe ofertat e tyre për punësim. Vlen për të përmendur se marrëveshjet me biznese në fushën e turizmit, hotelerisë dhe eventeve janë të pakta ose nuk janë finalizuar ende. Një pjesë e studentëve e kanë zhvilluar praktikën profesionale ose janë punësuar në kompani të kontaktuara prej tyre.*

**Komenti i FE\_GVB:** Së pari, sjellim në vëmendje që për të gjitha IAL-të viti akademik 2019-2020 ishte një vit i “vështirë”, për shkak të faktorëve të jashtëm (tërmeti nëntor 2019 dhe situatës shkaktuar nga pandemia Covid-19). Zhvillimi i praktikave profesionale (e cila zhvillohet në semestrin e dytë, në periudhën maj-qershor 2020) ishte e pamundur të realizohej në kushte normale pasi siç dihet, vendi ynë ishte i mbyllur për shkak të pandemisë.

Gjatë muajve të verës 2020 (korrik, gusht), pas heqjes së kufizimeve për shkak të Covid-19, studentët janë orientuar nga institucioni ynë për zhvillimin e praktikave në bizneset e tyre familjare dhe ato lokalë pranë vendbanimit të tyre, me qëllim ruajtjen e shëndetit të studentëve, pasi siç dihet kompanitë e biznesit që mundën të operojnë në fushën e turizmit dhe hotelerisë ishin më të rriskuara në përhapjen e infeksionit.

Lidhur me punësimin e studentëve sqarojmë se ky është viti i parë që janë diplomuar student në këtë program studimi dhe numri i tyre është relativisht i vogël (10 të diplomuar). Një pjesë e diplomuarve janë të punësuar në bizneset e tyre ose në biznese të tjera (Aneks.1.Lista e studentëve të punësuar), ku janë aktive (kryesisht biznese në fushën e turizmit dhe hotelerisë).

Fusha e turizmit në vend, ka pikë dobët ofrimin e shërbimit (shih Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023), në këtë kontekst punësimi i studentëve është në plotësim të kërkesës së tregut. Konkretisht të diplomuarit e këtij programi, janë punësuar në bizneset e tyre familjare, si dhe ato biznese.

Përsa i përket marrëveshjeve me biznese në fushën e turizmit, hotelerisë dhe eventeve, UMT ka të lidhura marrëveshje me kompani (*Aneks 2\_Printscreen të sistemit të ASCAL ku janë paraqitur marrëveshjet*), të cilat referuar numrit të studentëve, mundësojnë plotësisht zhvillimin e praktikave profesionale.

Në takimet me GVJ, është pranuar dhe sqaruar nga vetë ne se procesi i lidhjes së marrëveshjeve me bizneset është proces i vazhdueshëm zhvillimi dhe konsolidimi nga institucioni ynë, kjo ndikuar këtë vit akademik dhe nga pandemia.

Një tjetër element është fakti se në momentin që është përgatitur raporti, procesi i hartimit të marrëveshjeve ka qënë në proces zhvillimi dhe konsolidimi. Në vijim të procesit, një pjesë marrëveshjesh kanë qënë në proces dakordësimi, ndërsa një pjesë tjetër studentësh kanë bizneset e tyre familjare ku mund të punësohen si në Durrës, Golem, Ksamil dhe Tiranë. Duhet theksuar se janë biznese që operojnë direkt në këtë fushë

### **Përgjigje e GVJ:**

GVJ, bazuar në argumentimin e Institucionit por edhe në dokumentacion (Dokumentacion shtesë- Vizita dy ditore dhe dokumentacioni shtesë), vlerëson se Institucioni ka komunikime zyrtare dhe marrëveshje të lidhura apo në proces finalizimi për kryerjen e praktikës profesionale për studentët. Pasurimi i dosjes edhe me këto dokumente e sqaroi më mirë grupin.

**Në përfundim GVJ pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon.**

**Gjithashtu ndryshon edhe vlerësimi i standartit nga “pjesërisht” në “kryesisht”**

*II. GVJ\_Fusha I\_St 1.2 Kriteri 4: Institucioni është ende në fazën e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me qëllim që studentët të përfitojnë zhvillimin e praktikës dhe të kenë mundësi punësimi. Deri më tani për të dy vitet e studimit, studentët kanë përdorur lidhjet e tyre personale me qëllim që të zhvillojnë praktikat mësimore.*

**Komenti i FE\_GVB:** Sic është cituar dhe me lart, lidhja e marrëveshjeve është një proces i gjatë dhe i mirëorganizuar, dhe UMT ka marrëveshje bashkëpunimi (*Aneks 2 Printscreen të sistemit të ASCAL ku janë paraqitur marrëveshjet*) dhe referuar numrit të studentëve të regjistruar në këtë program, janë plotësisht të mjaftueshme për kryerjen e praktikave mesimore.

Fakulteti i Ekonomisë i UMT-së përveç marrëveshjeve zyrtare me operatorë të ndryshëm, ka lidhur dhe marrëveshje të tjera ku në disa raste pronarë janë edhe vetë familjet e studentëve.

Këto marrëveshje kanë garantuar zhvillimin e praktikës të studentëve. Gjithashtu, theksojmë se edhe njohjet personale të studentëve janë një element normal për zhvillimin e procesit mësimor. Duhet theksuar se janë biznese që operojnë direkt në këtë fushë.

Për shkak edhe të situatës COVID-19 dhe efekteve që ka krijuar në këtë sektor, shumë veprime janë zgjatur në kohë, por janë drejt finalizimit disa marrëveshje të tjera për praktikat e studentëve.

**Përgjigje e GVJ:** GVJ, bazuar në argumentimin në komentet e bëra nga Institucioni si edhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Dokumentacion shtesë- Vizita dy ditore dhe dokumentacioni shtesë), gjykon se Institucioni ka disa marrëveshje bashkëpunimi si edhe se vonesa për finalizimin e disa marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit është për shkak të situatës së vështirë në vend për shkak të pandemisë.

### **Në përfundim GVJ pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon**

**III. GVJ\_Fusha I\_St 1.2 Kriteri 5:** *Institucioni ka krijuar dhe ka në funksion inkubatorin e biznesit, i cili gjatë diskutimit me koordinatoren e programit të studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” na u prezantua si një projekt i realizuar me sukses në Universitetin Metropolitan të Tiranës pasi ofron një mundësi të mirë për studentët e IAL-së me qëllim që të zhvillojnë idetë e tyre të biznesit në fusha të ndryshme.*

*Ndër studentët e këtij programi vetëm një student është përfshirë në projektin e inkubatorit. Kjo në këndvështrimin e studentëve, gjatë takimit me ta, për shkak të mungesës së informacionit.*

*GVJ rekomandon nxitjen e studentëve për të qenë pjesë e këtij projekti meqenëse ky program studimi ka karakter profesional dhe idetë e biznesit janë të prekshme dhe praktike.*

**Komenti i FE\_GVB:** Ngritja e inkubatorit të biznesit në UMT është një risi në insitucionet e arsimit të lartë dhe përfshirja e studentëve në projektin “Metropolitan Incubator” të këtij programi është më i madh se 1. Ky fakt ndoshta nuk është bërë prezent sa duhej nga ana e institucionit tonë. Referuar dokumentacionit që mban në nivel institucional Koordinatorin i Incubator Metropolitan rezulton se janë 6 studentë të këtij programi të përfshirë në project (*Aneks 3: Lista e studentëve të programit MHTE pjesëmarrës ne Metropolitan Incubator dhe nr e kontaktit*), të cilët janë pajisur me certifikata që tregojnë pjesëmarrjen në aktivitete (shiko listën e emrave), lehtësisht të verifikueshme (mund të kontaktohen direkt dhe studentët pjesëmarrës), fakt të cilin do të donim të merrej në konsideratë nga GVJ.

Pavarësisht kësaj, theksojmë se puna vazhdon me intensitet për të rritur vëmendjen dhe pjesëmarrjen e studentëve në këtë projekt, duke marrë parasysh edhe nivelin e tyre të përgatitjes

**Përgjigje e GVJ:** GVJ bazuar në argumentat e dhëna nga Institucioni si edhe në dokumentacion (Aneksi 3 studentët e inkubatorit) pranon komentet e bëra prej Institucionit.

### **Në përfundim GVJ ndryshon Raportin**

**IV. GVJ\_Fusha II\_St 2.1 Kriteri 4:** *Për qëllimin e akreditimit të këtij programi studimi Departamenti i Shkencave të Administrimit ka vënë në dispozicion të GVJ planin mësimor së bashku me syllabuset përkatëse.*

*Syllabuset e vena ne dispozicion nga UMT, krahasuar me Planin mesimor kanë gabime /pasaktesi në specifika. Këto GVJ -ja komunikoi edhe GVB, ne takimin qe u zhvillua.*

**Komenti i FE\_GVB:** Po është i drejtë konstatimi, për disa lapsuse në syllabuset e lëndëve për shpërndarjen e krediteve ushtrime/seminar të cilat në disa syllabuse janë hedhur në formë të përmbledhur (psh 3 kredite ushtrime/seminare, në vend që të shkruhej 2 ETCS seminare dhe 1 ECTS ushtrime) nga profesori i lëndës.

Këto lapsuse janë konsideruar menjëherë që në momentin e takimit me GVJ dhe janë reflektuar, nën mbikëqyrjen direkte të Dekanit të Fakultetit.

**Përgjigje e GVJ:** GVJ gjykon se, syllabuset e vëna në dispozicion nga UMT, krahasuar me planin mësimor (Tabela 10 Plani mësimor) sikurse edhe me planin mësimor të vënë në dispozicion pas vizitës në institucion (Plan Mësimor Program Profesional 2 vjeçar në MTHE) kanë gabime /pasaktesi në specifika.

**Në përfundim GVJ nuk e ndryshon raportin**

**V. GVJ\_Fusha II\_St 2.1 Kriteri 5:** *Struktura e programit të studimit përmban një listë lëndësh me zgjedhje të cilat janë pjesë e kurrikulës me qëllim që të ofrojnë fleksibilitet në formimin e studentëve.*

*Duke ju referuar Evidencës 55 dhe takimeve të zhvilluara nga GVJ u vu në dukje se studentët ndjekin një plan mësimor në të cilën një pjesë e lëndëve marrin prapashitesën Turizëm por në syllabuse pasqyrohen konceptet bazë të lëndës, si psh: Bazat e Kontabilitetit në turizëm, syllabusi ofron baza të kontabilitetit. Në të njëjtën kohë, nga takimi me studentët dhe lektorët rezultoi se disa lëndë janë të vështira për studentët duke patur parasysh mesataren e tyre në hyrje (p.sh lënda Matematikë e aplikuar në biznes).*

*Gjithashtu vërehet se në planin mësimor ka vetëm një lëndë e cila lidhet me eventet, kjo bie ndesh me objektivat e programit të studimit, specialistët nuk mund të formohen duke ndjekur një lëndë të vetme por një grup lëndësh të cilat i japin atyre dijet e mjaftueshme për të performuar në tregun e punës.*

*Lëndët bazë në këtë program studimi duhet të jenë në përputhje me strategjinë e programit dhe objektivat e tij. Në këto kushte GVJ sugjeron që tre lëndët bazë të jenë njëra me qasje të hotelerisë, tjetra në restorante dhe e treta në evente. Duke patur këto lëndë bazë studenti është në gjendje të krijojë një kornizë të qartë mbi studimet që po ndjek.*

*Përgjatë takimeve, GVJ vuri në dukje se lëndët me zgjedhje duhet të jenë më të shumta në numër dhe të jenë të karakterit të turizmit, hotelerisë dhe eventeve, kjo me qëllim që studenti të zgjedhë ato lëndë të cilat përshtaten me interesin e thellimit të dijeve të tij.*

**Komenti i FE\_GVB:** Programi i studimit profesional 2 vjeçar është miratuar dhe licensuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, bazuar në vlerësimin në përmbajtje me ekspertë të fushës të përzgjedhur nga ASCAL. Plani mësimor i paraqitur në kuadër të licensimit dhe i zbatuar në UMT përmban strukturën dhe tipologjinë e lëndëve sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

Lëndët bazë si: Konceptet bazë në Matematikë, Kontabilitet apo Marketing të cilat konsiderohen si lëndë të cilat japin njohuri të konsoliduara dhe të përdorshme në shumë fusha të aktivitetit..

Sasia dhe cilësia e njohurive sipas lëndëve që stafi akademik transmeton tek studentët e këtij programi është bërë duke mbajtur në konsideratë profilin profesional të programit të studimit.

Në këtë kontekst, janë përgatitur materialet didaktike (shih vlerësimin e GVJ tek fusha III, standarti 3.1, kriteri 3 & 4) nga pedagogët e lëndëve (leksione të shkruara, detyra, raste me role play, diskutime etj) që lidhen specifikisht me fushën e programit të studimit duke ndikuar në aplikime praktike dhe aftësuar

studentët për të zgjidhur probleme praktike.

Disa lëndë është e pamundur të hiqen nga programi, (që në hartimin e programit nga UMT, si dhe nga vlerësimi i ekspertëve në kuadër të licensimit, të cilët nuk kanë lënë rekomandime të kësaj natyre) në gjykimin tonë profesional ato japin njohuri bazë që çdo student duhet të ketë, pavarësisht fushës. Psh: Matematika pavarësisht vështirësisë, nuk mund të hiqet fare nga programi sepse studentët duhet të kenë bazat e kalkulimeve. Por theksojmë se njohuritë për këto lloj lëndësh janë të mirëpërcaktuara nga ana sasiore dhe në përmbajtje, në funksion të programit të studimit.

Përsa i përket lëndëve me zgjedhje, GVB\_FE shprehet tërësisht dakord për rritjen e numrit të tyre, sipas sugjerimeve të GVJ.

Vëmë në vëmendjen Tuaj, se referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndryshimet në një program studimi (plan mësimor), behen pasi programi ka kaluar fazën e testimit të tij konkret.

**Përgjigje e GVJ:** Sikurse në RVJ, GVJ nuk shprehet për heqjen e lëndëve si psh të Matematika e aplikuar, por përfshirjen në këtë program studimi një lëndë të thjeshtuar të Matematikës duke ditur edhe nivelin e studentëve. Sygjerimi që GVJ jep për modifikimin e programit të studimit, është për të ndryshuar, modifikuar apo përmirësuar duke ju referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Në përfundim GVJ nuk e ndryshon raportin**

**VI. GVJ\_Fusha II\_St 2.2 Kriteri 2:** *Programi i studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” është i shpërndarë në vite dhe semestra si dhe i organizuar në kredite dhe orë mësimore në përputhje të plotë me ligjit për arsimin e lartë 80/2015 si dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018 si dhe aktet nënligjore në mbështetje të këtij ligji.*

*Kjo ndarje shpërndarje mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Orët në auditor dhe jashtë tij i japin studentit informacionin e nevojshëm formimin e tij dhe përgatitjen për tregun e punës.*

*Në një pjesë të lëndëve kishin si prapashtesë në titullin e tyre fjalën turizëm, por në syllabus nuk kishin asnjë specifikë dhe veçanti të turizmit, (psh. Hyrje në ekonominë e turizmit është Hyrje në ekonomi, Marketing në turizëm është Marketing etj).*

*Gjatë vizitës së tij GVJ vuri në dukje se një pjesë e madhe e lëndëve të planit mësimor janë me karakter ekonomik të përgjithshëm, ndërkohë që studentët e degëve me karakter profesional kanë nevojë për lëndë të profilit të tyre. Këtu mund të përmendim faktin se për degën e studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” ka vetëm një lëndë në fushën e eventeve. GVJ gjykon se vetëm një lëndë nuk është e mjaftueshme për të formuar specialist të fushës së eventeve, sikundër programi i studimit është emërtuar.*

*GVJ sygjeron që kur të mendohet rishikimi i planit mësimor, stafi përgjegjës të jetë i kujdesshëm në emërtimin e lëndëve dhe për më tepër titulli i lëndës të justifikojë përmbajtjen e syllabusit.*

**Komenti i FE GVB:** Sic kemi sqaruar dhe më lart, disa njohuri konceptohen të njëjta pavarësisht fushës së studimit. Psh konceptet bazë në Matematikë, Kontabilitet apo Marketing nuk ndryshojnë, por sasia e njohurive që profesorët transmetojnë tek studentët është bërë në funksion të formimit profesional të tyre.

Literatura bazë për disa lëndët të sipërpërmendura është e vështirë që të gjendet në gjuhën shqipe, por



lektorët përveç leksioneve të hartuara, japin detyra dhe realizojnë diskutime interaktive që lidhen specifikuisht me fushën e tyre.

Në vijim të argumentave më lartë, mund të shtojmë se në fushën e hotelerisë dhe të turizmit zhvillohen një numër i konsiderueshëm lëndësh të cilat i japin studentit një formim teoriko-praktik të mjaftueshëm për të operuar në sistemin e menaxhimit të Turizmit dhe të hotelerisë. Theksojmë se ky është një program studimi në fushën e Menaxhimit në përgjithësi dhe jo të operacioneve në veçanti. Pjesa më e madhe e lëndëve kanë karakter profesional sipas drejtimit ku mund të përmendim: Turizmi Ndërkombëtar, Menaxhim SME, Ekoturizmi dhe Turizmi Rural, Zhvillim i Guidës Turistike, Etikë Biznesi në Turizëm, Strategji Biznesi në Turizëm, Menaxhim Eventesh, Bazat e Menaxhimit të Biznesit Turistik.

**Përgjigje e GVJ:** Sikurse edhe është shprehur në RVJ, GVJ thekson se titulli i lëndëve dhe përmbajta e syllabusit duhet të jenë në përputhje. Psh. nëse lënda është Marketing, nuk ka nevojë që në titull të jetë Marketingu i Turizmit. GVJ është plotësisht dakort që në të tilla lëndë, pavarësisht se mund të jenë lëndë që japin një formim dhe informacion të përgjithshëm dhe konceptet nuk ndryshojnë, pedagogët e përshtasin përmbajtjen me rastet studimi, ushtrime etj në fushën e turizmit.

**Në përfundim GVJ nuk e ndryshon raportin**

*VII. GVJ\_Fusha II\_St 2.2 Kriteri 2: GVJ vuri re se një pjesë e lëndëve në planin mësimor janë më shumë të karakterit ekonomik dhe jo në përputhje me misionin e programit të studimit. Gjatë bisedës me studentët ka lëndë të cilat perceptohen prej tyre si tepër të ngarkuara për programin e tyre. Këtu mund të përmendim lëndën Matematikë e aplikuar në Biznes e cila sipas mendimit të profesorit të lëndës, dhe studentëve që e kanë ndjekur lëndën, konsiderohet një lëndë që nuk ka ndikim në formimin profesional të studentëve dhe që shkalla e vështirësisë është e madhe për nivelin e studentëve të rregjistruar në këtë program studimi.*

**Komenti i FE\_GVB:** GVB konstaton se Matematika është një lëndë me karakter bazë në të gjitha fushat e ekonomisë duke përfshirë edhe turizmin. Profesorët e lëndës përpiqen që të lehtësojnë njohuritë që studentët duhet të përvetësojnë, por heqja e kësaj lënde nga programi paraqet probleme në akumulimin e njohurive të nevojshme që një student duhet të zotërojë në fund të ciklit përkatës. Syllabusi përmban kryesisht metoda matematikore të thjeshta që aplikohen në biznesin e turizmit.

**Përgjigje e GVJ:** Në RVJ, grupi i jashtëm nuk është shprehur për heqjen e lëndës së matematikës por ka shprehur mendimin e studentëve në lidhje me këtë lëndë. Kursesi GVJ nuk mohon dhe anashkalon rëndësinë e matematikës në formimin e përgjithshëm të studentëve, por konstatimi që shkalla e vështirësisë për këtë lëndë u evidentua nga takimi me studentët. Gjithsesi GVJ shprehet më qartë duke e riparë këtë pikë në raport.

**Në përfundim GVJ pranon pjesërisht komentin e IAL dhe Raporti ndryshon**

*VIII. GVJ\_Fusha II\_St 2.2 Kriteri 5: Për sa i përket përmbajtjes së planit mësimor në lëndë, është e nevojshme ndërhyrja dhe riorganizimi i këtij programi me qëllim nxitjen e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës. Gjatë takimit me NJSBC-në, GVJ vuri në dukje rëndësinë e hartimit të planit mësimor në bashkëpunim me bizneset dhe studentët, gjë kjo e cila do të krijonte*

*mundësinë për një plan mësimor që i vjen në ndihmë studentëve dhe bizneseve të interesuar për të patur punonjës në këtë fushë studimi.*

**Komenti i FE\_GVB:** së pari, që në hartimin e programit të studimit në kuadër të licensimit, në përbërjen e Grupit të Punës ka patur pedagoge që njëkohësisht janë ofrues privat të shërbimeve të turizmit, hotelerisë dhe eventeve.

Ndërkohë, ky është brezi i parë i të diplomuarve (ALUMNI) dhe analiza e programit të studimit në kontekstin e përmirësimeve sipas kërkesave të tregut të punës, do të jetë në vijimësi, pas përfitimit të përvojës në punë e këtyre të diplomuarve.

Nga eksperiencia e këtyre dy viteve, si dhe nga feedback-u që po mblidhet nga të gjithë aktorët e përfshirë, programi synon përmirësimin e të gjitha objektivave të synuara. Duhet të theksojmë se GVB ka parë të arsyeshme që të kalohet akreditimi i parë i programit dhe në varësi të sugjerimeve të bëjë ndryshimet e nevojshme.

Risjellim në vëmendjen Tuaj, se referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndryshimet në një program studimi (plan mësimor), bëhen pasi programi ka kaluar fazën e testimit të tij konkret dhe akreditimit të parë të programit, për të bërë përmirësimet konkrete, që është dhe qëllimi parësor i këtij procesi.

**Përgjigje e GVJ:** Sygjerimi i bërë nga GVJ është që të ketë rishikim të planit mësimor në të ardhmen duke synuar përmirësimin e tij.

**Në përfundim GVJ nuk e ndryshon raportin**

*IX. GVJ\_Fusha II\_St 2.3 Kriteri 1: Programi i studimit në “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” përmban të dhëna të plota mbi formimin teorik dhe praktik të studentëve. Studentit i vihet në dispozicion plani mësimor si dhe syllabuset për çdo lëndë të ndjekur gjatë periudhës së formimit të tij. Gjatë takimeve të realizuara GVJ ju vu në vëmendje se studenti në momentin e regjistrimit ka në dispozicion planin mësimor që do të ndjekë. Ndërsa syllabuset i vihen në dispozicion në fillim të çdo lënde, kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me studentët. Bazuar në rregulloren e UMT, të FE dhe të programit të studimit procedura e informimit të studentit mbi programin nuk është shumë e qartë pasi nuk përmendet informimi i tij si detyrë e ndonjë departamenti të caktuar.*

**Komenti i FE\_GVB:** Lidhur me informimin mbi programet e studimit që ofrohen në UMT, është një sistem i institucionalizuar tashmë që në momentin kur individët janë të interesuar për programet e UMT. Në këtë kontekst, çdo aplikant potencial për t'u pranuar në programet e studimit (përfshirë dhe të këtij programi), fillimisht priten nga zyra e pranimeve, me pas drejtohen në departamentin përkatës për tu njohur me ofertën didaktike të programit të studimit (plani mësimor, kohëzgjatja në vite, numri i krediteve në vit, frekuentimi i detyrueshëm etj).

Ky informacion jepet nga përgjegjësi i departamentit, personeli akademik i tij, si dhe shpesh herë dhe nga Dekani i Fakulteti

Për studentin e regjistruar, i vihet në dispozicion plani mësimor që do të ndjekë, si dhe syllabusi i lëndës nga pedagogu përkatës.

**Përgjigje e GVJ:** GVJ në RVJ është shprehur për procedurat e informimit të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Kështu, bazuar në argumentat e dhëna nga institucioni në komentet e bëra për këtë kriter, GVJ gjykon të arsyeshme ndryshimin që do të pasqyrohej në RVJ.

**Në përfundim GVJ pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon**

**X. GVJ\_Fusha II\_St 2.3 Kriteri 2-3:** *GVJ mendon se nuk është e qartë pritshmëria e bizneseve dhe përmbushja e saj nga ana e studentëve. Në të njëjtën kohë nuk ekziston asnjë evidencë me anë të së cilës të tregohet punësimi i studentëve në vendet ku kanë zhvilluar praktikën mësimore, gjë e cila e pengon GVJ në lidhje me dijet e fituara nga studentët dhe vënien në praktikë të këtyre dijeve.*

**Komenti i FE\_GVB:** Është brezi i parë i të diplomuarve dhe jemi në pritje të informacionit të punësimit të tyre (sipas rregullores se zyrës përgjegjëse për karrierën ky informacion finalizohet deri në 6 muaj pas diplomimit). Theksojmë se në këto momente bizneset në fushën e turizmit, hotelerisë dhe eventeve po hasin vështirësi për shkak të kufizimeve nga Covid-19.

**Përgjigje e GVJ:** GVJ në RVJ ka patur për qëllim të shprehë që vlerësimi dhe performanca e këtij programi studimi nuk mund të vlerësohet tani pasi në këtë vit akademik janë të diplomuarit e parë dhe nuk ka patur evidenca për punësimin e studentëve. Për të qenë më të qartë për këtë vlerësim GVJ gjykon si të drejtë komentin e institucionit dhe pranon ndryshimin e pjesshëm të raportit për këtë pikë.

**Në përfundim GVJ pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon pjesërisht.**

**XI. GVJ\_Fusha II\_St 2.3 Kriteri 4:** *Gjatë vizitës në IAL dhe takimeve të zhvilluara, sidomos në takimin me studentët, evidentohet rëndësia e kryerjes së praktikës mësimore dhe asaj profesionale. Studentët e shikojnë mundësinë e praktikës si një mënyrë të mirë për të vënë në jetë dijet e tyre. Madje në këtë takim u vu në dukje fakti se studentët ndjejnë nevojën për praktikë në të gjitha lëndët e zhvilluara.*

*Një pjesë e studentëve kanë zgjedhur këtë program studimi duke qenë se janë të angazhuar në fushën e turizmit, hotelerisë dhe eventeve. Por një pjesë tjetër e tyre nuk janë të angazhuar në këtë fushë dhe kanë pritshmëri më të larta për zhvillimin e praktikës dhe krijimin e mundësive të punësimit.*

**Komenti i FE\_GVB:** Grupi i punës argumenton se për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, shumë biznese që operojnë në këtë industri, u mbyllën ose e reduktuan nivelin e veprimtarisë së tyre shpesh deri në minimum, situatë kjo që ndikoi negativisht edhe në marrëdhëniet e krijuara më parë në lidhje e realizimin e praktikave me sukses. Gjithsesi, fakulteti ka qenë gjithë kohës i angazhuar për të optimizuar përmbushjen e të gjitha objektivave që vetë programi kërkon të përmbush.

**Përgjigje e GVJ:** GVJ ka dhënë në RVJ një konstatim të bërë gjatë takimit me studentët.

**Në përfundim GVJ nuk e ndryshon raportin**

**XII. GVJ\_Fusha III\_St 3.1 Kriteri 5:** *Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion si dhe gjatë takimit me profesorët e programit të studimit, takimit me përgjegjës të departamentit apo NJSBC u vu re se institucioni nuk ofron trajnime të mirëfillta në*

*fushën e mësimdhënies. Për tu ardhur në ndihmë profesorëve të rinj departamenti mundëson ndjekjen e leksioneve tek kolegët por nuk ka metoda të tjera trajnuese për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni mundëson pjesëmarrjen e stafit në projekte të shkëmbimit të profesorëve, si projektet Erasmus+, në të cilat secili prej lektorëve të programit të studimit gjatë takimit pranoi se kishte qenë të paktën një herë pjesëmarrës.*

**Komenti i FE\_GVB:** Mentorimi në vendin e punës është një ndër praktikatat më të njohura dhe më efektive për përmirësimin e aftësive të punonjësve ose në këtë rast i lektorëve përkatës, për përmirësimin dhe zhvillimin e kompetencave të tyre për realizimin me sukses të funksioneve të tyre në ushtrimin e detyrave përkatëse.

Universiteti ka ndjekur këtë teknikë trajnimi duke e konsideruar si më efektiven dhe më të përshtatshmen për lektorët e rinj. Një pjesë e pedagogëve janë të lidhur direkt me menaxhimin e kompanive turistike si menaxher apo specialistë në këto kompani (shiko listën).

Ndërkohë që siç është cituar dhe në komentin e GVJ që cdo pedagog i këtij programi studimi, ka qenë pjesëmarrës në projektin Erasmus +, në kuadër të mobilitetit të stafit akademik, në funksion dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies.

Ndërkohë në analizat e përvitshme që bëhen në nivel departamenti, nuk ka rezultuar nevoja për ofrimin e trajnimeve specifike për mësimdhënësit.

**Përgjigje e GVJ:** GVJ në RVJ ka vlerësuar që cdo anëtar i stafit akademik ka patur mundësinë e pjesëmarrjes në projektin Erasmus +. GVJ ka evidentuar që nuk ka trajnime të vecanta për mësimdhënien për pedagogoet e rinj. GVJ, bazuar në argumentat e dhëna nga Institucioni pranon të ndrshojë raportin në këtë pikë.

**Në përfundim GVJ pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon**

**Gjithashtu ndryshon edhe vlerësimi i standartit nga “kryesisht” në “plotësisht”**

*XIII. GVJ\_Fusha III\_St 3.3 Kriteri 3: Në tërësinë e aktiviteteve të UMT një vend të rëndësishëm zë rritja e vazhdueshme e nivelit kërkimor-shkencor të stafit akademik duke përfshirë edhe studentët në Konferenca Studentore, projekte apo inkubatorin e biznesit, me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Por Studentët e këtij programi studimi nuk janë përfshirë në aktivitete të tilla.*

**Komenti i FE\_GVB:** Grupi i jashtëm konstaton se përfshirja e studenteve është realizuar me përfshirjen në inkubatorin e biznesit kur vullneti dhe interesi i studentit ka qenë i njëjtë me atë të institucionit. Sa i përket përfshirjes në konferenca dhe kërkim shkencor, përfshirja e kësaj kategorie studentësh është e limituar pasi vetë programi ka fokus zhvillimin profesional të studentëve, dhe jo përgatitjen e tyre për nivele kërkimi dhe zhvillimi akademik të mëtejshëm.

**Përgjigje e GVJ:** GVJ në RVJ shprehet për mos pjesëmarrje të studentëve në aktivitete si Konferenca Studentore por nuk ka arritur të shprehet pse kjo ndodh. Komenti i GVB është i drejtë që këta studentë kanë formim profesional dhe jo shkencor.

**Në përfundim GVJ pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon.**

**XIV. GVJ\_Fusha III\_St 3.5 Kriteri 5:** Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion GVJ konstaton se IAL-ja ka hartuar dhe ndjek veprimtarinë e studentit deri në përmbylljen e studimeve të tij. Studenti është nën vëmendjen e lektorëve dhe institucionit për përmbushjen e detyrimeve dhe mbylljen me sukses të procedurave të posaçme të hartuara për realizimin e diplomimit.

*Diplomimi i studentëve bazohet në rregulloren e programit të studimit Kreu VI Neni 26. Por ky nen nuk ka detaje të mjaftueshme mbi procedurën e diplomimit, dokumentat që duhet të dorëzohen, hartimin e temës së diplomës (në rast se studentit zgjedh të hartojë një temë), gjithashtu në këtë nen nuk ka detaje mbi provimin e diplomimit (në rastin kur studentit diplomohet me provim).*

*GVJ sugjeron hartimin e një rregullore të veçantë për programin e studimit pasi kjo e fundit do të plotësonte boshllëqet që hasen në rregulloren e fakultetit.*

**Komenti i FE GVB:** Për vlerësimin në përmbyllje të studimeve të programit profesional MHTE, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (LAL80/2015, neni 72, si dhe VKM nr.41/2018 e ndryshuar), nuk ka përcaktim për formën e diplomimit të studentëve në përmbyllje të detyrimeve akademike (sic janë të përcaktuara për programet Bachelor, Master Profesional apo Master i Shkencave). Fakulteti i Ekonomisë për këtë program studimi, në kushtet e pandemisë, ka vendosur që studentët e parë të këtij brezi të diplomohen me provim përfundimtar (siç është parashikuar dhe në plan mësimor). Studentët që në fillim të semestrit të dytë, të viti të dytë ju behën të njohura elementët e provimit përfundimtar, sipas përcaktimeve të qarta në Rregulloren e UMT, neni 58 (Evidenca 2, që mbështet RVB).

Për sa i përket rekomandimit për mbrojtje të diplomës me teme diplome, vlerësojmë se do të mundësohet në vitet pasardhëse duke monitoruar në vijimësi dhe arritjet e studentëve gjatë vitit të parë dhe vitit të dytë/semestrit të II të studimeve. Kjo njëkohësisht do të shoqërohet dhe me rregulloren specifike të punimit dhe mbrojtjes së diplomës për këtë lloj programi, sic janë dhe për programet master i shkencave që ofron FE, UMT

**Përgjigje e GVJ:** Nuk ka koment për të bërë, pasi është shprehur në RVJ për këtë kriter.

**Në përfundim GVJ nuk e ndryshon raportin**

**Gjithashtu ndryshon edhe vlerësimi i standardit të fushës III nga “kryesisht” në “plotësisht”**

## Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “MENAXHIM NË TURIZËM, HOTELERI DHE EVENTE”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi me karakter profesional i studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” i ofruar nga Departamenti i Shkencave të Administrimit në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin Metropolitan Tirana është në përputhje me qëllimet, misionin e institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të tij.  <i>Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 3 UMT Plani strategjik i zhvillimit të UMT</i>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Programi i studimit “Menaxhim në Hoteleri, Turizëm dhe Evente” ofrohet në përputhje me Statutin dhe rregulloren e Universitetit Metropolitan Tirana.  GVJ vë në dukje se statuti dhe rregullorja e institucionit theksojnë elementë si: misioni, niveli i mësimdhënies, kërkimi shkencor, specializimi i stafit, etj dhe realizimi i këtij programi studimi mbështetet në këto pika të cilat vënë në dukje ruajtjen e cilësisë.  Bazuar në <i>Evidencën 53</i> drejtimit prioritar të programit janë në përputhje me statutin dhe rregulloren e UMT-së.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacioneve si dhe përgjatë vizitës së zhvilluar në IAL grupi i vlerësimit të jashtëm vuri re se programi i studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë që e ofron këtë program.  <i>Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 3 UMT Plani strategjik i zhvillimit të UMT</i> <i>Evidenca 53 Te dhena te pergjithshme per programin e studimit</i>
<b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion GVJ konstaton se për hapjen e këtij programi studimi nga institucioni është zhvilluar një analizë tregu e bazuar në të dhëna dytësore, më së shumti financiare, si dhe një analizë e detajuar e tyre. Sipas kësaj analize, studimet me karakter profesional do t’i ofrojnë gjimnazistëve mundësinë për t’u shkolluar dhe për t’u përfshirë në një nga fushat me të ardhura më të larta në vend.  GVJ konstaton se kjo analizë nuk është mbështetur në kërkesat dhe pritshmëritë e bizneseve apo kërkesat e gjimnazistëve (një

	<p>ndër grupet kryesore të interesit).</p> <p>GVJ sygjeron që nga institucioni të bëhet një analizë më e saktë dhe e kompletuar duke u bazuar në figurën që kompanitë duan dhe kanë nevojë për të punësuar dhe që nuk mund ta gjejnë në tregun e punës. Një studim i tillë do të ndihmonte për të përmirësuar planin mësimor duke e ndryshuar dhe e përshtatur me nevojat e tregut.</p> <p><i>Evidenca 74 Studim Tregu per programin</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga të dhënat e vendosura në dispozicion grupi i vlerësimit të jashtëm nuk konstaton ndonjë planifikim për analizimin e tregut dhe ndryshimet që mund të ndodhin në të, në periudha të ndryshme kohore.</p> <p>Një element i cili duhet mbajtur në konsideratë është dhe koha e shkurtër përgjatë së cilës programi i studimit ka qënë aktiv. Në një periudhë kohe dyvjecare tregu nuk ka pësuar ndryshime të mëdha.</p> <p><i>Evidenca 74 Studim Tregu per programin</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Studimi për hapjen e këtij programi studimi është mbështetur në mundësitë e punësimit të studentëve dhe zhvillimin e pritshëm të sektorit të turizmit, hotelierisë dhe eventeve.</p> <p>GVJ konstaton se për shkak të situatës së vështirë të krijuar në vend për shkak të Covid 19 dhe sidomos në fushën e turizmit si një nga sektorët më të prekur, marrëveshjet me biznese në fushën e turizmit, hotelierisë dhe eventeve janë të pakta ose në proces finalizimi. Një pjesë e studentëve e kanë zhvilluar praktikën profesionale ose janë punësuar në kompani të të familjareve apo të afërmeve të tyre. Viti akademik 2019-2020 ka edhe të diplomuarit e parë në këtë program studimi. Sugjerohet shtimi i marrëveshjeve për praktikat mësimore profesionale.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi I.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti Metropolitan i Tiranës funksionon në bazë të një strukture organizative, në të cilën secila prej njësisve mban përgjegjësitë e saj. Detyrat janë të ndara qartë dhe të specifikuara gjë kjo e cila ndikon në zgjidhjen e problematikave të studentëve të përfshirë në këtë program studimi.</p> <p>Përgjatë vizitës në IAL u vu re se ka një bashkëpunim të ngushtë mes stafit, punonjësve administrativ dhe drejtuesve të institucionit</p>

	<p>me qëllim që të përmbushet misioni i institucionit dhe i programit të studimit. Programi i studimit Menaxhim në Turizëm Hoteleri dhe Evente është realizuar mes bashkëpunimit të departamentit të shkencave të administrimit me senatin akademik dhe NJSBC.</p> <p>Gjatë takimit me përgjegjës të departamentit GVJ u informua se programi është iniciuar nga departamenti më pas ka kaluar për miratim në dekanat dhe është miratuar nga Senati. Gjatë takimit me NJSBC gjithashtu u vu në dukje dhe bashkëpunimi i kësaj njësie me departamentin. Roli i NJSBC-së lidhet më së shumti me organizimin e kurrikulës nga ana strukturore.</p> <p>Gjithashtu bazuar edhe në të dhënat e vëna në dispozicion Departamenti i Shkencave të Administrimit zhvillon analiza (Evidenca 73) në periudha të ndryshme kohore me qëllim përmirësimin e programit të studimit dhe punës së departamentit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Administrimit është i përfshirë në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare por studentët e programit të studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” nuk kanë qënë pjesëmarrës në këto projekte.</p> <p>Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion të vërtetuara edhe gjatë vizitës së zhvilluar marrëveshjet me institucione homologe, punëdhënës vendas apo të huaj për këtë program studimi janë të pakta ose ende nuk janë finalizuar nga institucioni. Gjatë takimit me punonjësit e zyrës së karrierës Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u sqarua se këto marrëveshje janë në fazën e finalizimit të tyre, por ende nuk janë vënë në jetë. Për këtë arsye nuk mund të pretendojmë për një analizë të përfitimit nga marrëveshjet.</p> <p>Gjatë takimit GVJ ju bë me dije se një pjesë e këtyre marrëveshjeve nuk ishte finalizuar për shkak të mbylljes së universitetit dhe kompanive të industrisë së turizmit dhe eventeve nga pandemia COVID19. GVJ ju bë me dije se marrëveshjet janë shtyrë për një kohë të mëvonshme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni është ende në fazën e finalizimit të lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani në fushën e turizmit, me qëllim që studentët të përfitojnë zhvillimin e praktikës dhe të kenë mundësi punësimi, dhe kjo vonesë është për shkak të situatës së vështirë në vend për shkak të pandemisë. Deri më tani, për të dy vitet e studimit, pjesa më e madhe e studentëve e kanë zhvilluar praktikat mësimore në bizneset e tyre familjare apo tek të njohurit e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni ka krijuar dhe ka në funksion inkubatorin e biznesit, i cili gjatë diskutimit me koordinatoren e programit të studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” na prezantua si një projekt i realizuar me sukses në Universitetin Metropolitan të Tiranës pasi ofron një mundësi të mirë për studentët e IAL-së me qëllim që të zhvillojnë idetë e tyre të biznesit në fusha të</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Institucioni ka krijuar dhe ka në funksion inkubatorin e biznesit, i cili gjatë diskutimit me koordinatoren e programit të studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” na prezantua si një projekt i realizuar me sukses në Universitetin Metropolitan të Tiranës pasi ofron një mundësi të mirë për studentët e IAL-së me qëllim që të zhvillojnë idetë e tyre të biznesit në fusha të</p>



	<p>ndryshme.</p> <p>Ndër studentët e këtij programi pak studentë janë përfshirë në projektin e inkubatorit. Kjo në këndvështrimin e studentëve, gjatë takimit me ta, për shkak të mungesës së informacionit.</p> <p>GVJ rekomandon, pavarësisht nivelit të studentëve të këtij programi studimi, nxitjen e studentëve për të qenë pjesë më aktive e këtij projekti meqenëse ky program studimi ka karakter profesional dhe idetë e biznesit janë të prekshme dhe praktike.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**Standardi I.3**  
**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit është i organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve dhe në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi (L. 80/2015 dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018). Ky program është i organizuar në: lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe detyrime përmbjllëse.</p> <p>Sasia e krediteve për lëndë është e harmonizuar dhe në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018.</p> <p><i>Evidenca 55 Plani mesimor sipas llojit të veprimtarisë</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	<p>Programi i studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” është krijuar nga njësi bazë me qëllimin që të ofrojë njohuri të specializuara në fushën e turizmit, hotelierisë dhe eventeve. Gjithashtu ky program studimi është krijuar me synimin që të pajisë studentin me praktikë mësimore dhe me dije të fituara në vendin e punës, metodë kjo e menduar nga IAL-ja si metoda më e mirë e përgatitjes së studentëve në këtë fushë studimi.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.	<p>Për të përmbushur synimin e përfitimit të aftësive në vendin e punës studenti në këtë program studimi ndjek 2 herë praktikë mësimore gjatë studimeve të tij: një herë në semestrin e parë si lëndë më vete, dhe një herë në përmbjllje të studimeve. Praktika e dytë (Praktika Profesionale) është me një kohëzgjatje prej pesë (5) javësh dhe me anagazhim të vazhduar të studentit në vendin e punës.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.	<p>Gjatë vizitës në IAL nga diskutimet me lektorët e programit të studimit na u vu në dukje rëndësia e praktikës dhe njohurive që studenti merr nga kjo eksperiencë.</p> <p>Ky program studimi synon të pajisë studentët me kompetenca për menaxhimin dhe mbikëqyrjen në kuadrin e veprimtarive profesionale</p>

	<p>dhe orientimin e duhur në situatë të ndryshme dhe të ndryshueshme. Gjatë takimit me stafin akademik të programit GVJ ju vu në dukje se gjatë leksioneve studentët marrin informacion mbi situatë të ndryshme me të cilat ata mund të përballen dhe shpesh atyre u stimulohen skenare/situatë në të cilat duhet të marrin vendime të menjëhershme. Gjë kjo e cila u përmend dhe nga studentët gjatë takimit të zhvilluar me ta.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia kryesore /kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkollës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Programi i studimit mbulohet nga lektorë me tituj dhe grada në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet e tij mbështetëse.</p> <p>Fakuleti Ekonomik pranë Universitetit Metropolitan Tirana ka në përbërje të tij:</p> <p><b>Për vitin 2018-2019:</b> 60 pedagogë, nga të cilët <b>23 PAE</b> dhe <b>37 PAK</b>.</p> <p><b>Për vitin 2019-2020:</b> 78 pedagogë, nga të cilët <b>33 PAE</b> dhe <b>45 PAK</b>.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Administrimit ka pasur në përbërje të tij sipas viteve si më poshtë:</p> <p><b><u>për vitin akademik 2018-2019:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Prof.Dr</li> <li>• 1 Prof.Asoc.Dr.</li> <li>• 8 Dr</li> <li>• 1 Msc</li> </ul> <p><b><u>për vitin akademik 2019-2020:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 5 Prof. Dr</li> <li>• 1 Prof.Asoc.Dr.</li> <li>• 10 Dr</li> <li>• 6 Msc</li> </ul> <p>Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion (Tabela 12), GVJ konstaton që 68% të orëve mësimore (81 kredite) mbulohen nga stafi akademik PAE dhe 32% të orëve mësimore (39 kredite) mbulohen nga stafi akademik PAK.</p> <p><i>Evidenca 66 FE Lista e Plotë e personelit akademik të FE me kohë të plotë, me kohë të pjesëshme FE</i></p> <p><i>Evidenca 68 FE Të dhëna statistikore të personelit akademik PAE PAK</i></p> <p><i>Tabela 1 Numri i personelit Akademik per cdo njesi baze (2019-2020)</i></p> <p><i>Tabela 7 Te dhena permbledhese te stafit akademik sipas kualifikimit</i></p> <p><i>Tabela 4, ngarkesa totale 2018-2019</i></p> <p><i>Tabela 6.1, Cilesia e stafit akademik, 2018-2019</i></p>

	<p><i>Tabela 12.1, Plani mesimor i lidhur me stafin akademik, 2018-2019</i></p> <p><i>Tabela 12 Plani mesimor i lidhur me personelin akademik perkates.</i></p> <p><i>Tabela 6 Cilesia e stafit mesimdhene per programin e studimit</i></p> <p><i>Tabela 12 Plani mesimor i lidhur me personelin akademik perkates</i></p> <p><i>Evidenca 69 Te dhena per mbulimin e lendeve me personel akademik</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar qartë objektivat e formimit profesional për studentët dhe përfshin dijet, aftësitë dhe kompetencat që duhet të zotërojë një i diplomuar në programin me karakter profesional në “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente”.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<p><b>Standardi II.1</b></p> <p><b>Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” ka të përcaktuar qartë objektivat e formimit të studentëve, kompetencat dhe njohuritë që studenti duhet të ketë në hyrje të programit dhe në dalje të tij.</p> <p>Ky program synon të ofrojë elementet dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e aftësive dhe njohurive në fushën e turizmit. Në <b>evidencën 53 pika II</b> pasqyrohen qartë objektivat për këtë program studimi si dhe njohuritë që studentët duhet të kenë në përfundim të tij. GVJ gjykon se plani mësimor ka nevojë për rishikim pasi një pjesë e lëndëve të ofruara nuk ndikojnë në formimin profesional të studentëve, gjë e cila bie ndesh me misionin dhe prioritetet dhe strategjinë e zhvillimit për këtë program studimi.</p>

	<p><i>Evidenca 58 Rregullore e programit</i></p> <p><i>Evidenca 53 Te dhena te pergjithshme per programin e studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Plani mësimor i këtij programi studimi është i hartuar sipas ligjit për arsimin e lartë 80/2015 si dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018. Plani mësimor është i organizuar me 120 kredite. Për të shlyer detyrimet e një viti studimi, studenti duhet të marrë 60 kredite në vit. Bazuar në planin mësimor të vënë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 15 % (ose 18 Kredite) janë <b>Lëndë Bazë</b>,</li> <li>• 55% (ose 66 Kredite) janë <b>Lëndë karakterizuese</b></li> <li>• 10% (ose 12 Kredite) janë <b>Lëndë ndërdisiplinore/integruese</b></li> <li>• 15% (ose 18 Kredite) janë <b>Lëndë plotësuese</b></li> <li>• 5% (ose 6 Kredite) janë <b>Detyrime përmbyllëse</b></li> </ul> <p>Syllabuset e paraqitura për këtë program studimi japin një informacion të detajuar në lidhje me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit, ndjekjen e lëndës, rregullat e auditorit, institucionit, etj.</p> <p>Praktika mësimore dhe ajo profesionale janë gjithashtu të prezantuara me anë të një syllabusi i cili sqaron detyrimet e studentit për përmbylljen e praktikës.</p> <p><i>Evidenca 56 Plan Programet e lendeve viti 1</i></p> <p><i>Evidenca 56.1 Plan Programet e lendeve viti 2</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Për qëllimin e akreditimit të këtij programi studimi Departamenti i Shkencave të Administrimit ka vënë në dispozicion të GVJ planin mësimor së bashku me syllabuset përkatëse.</p> <p>Syllabuset e vena ne dispozicion nga UMT, krahasuar me Planin mesimor kanë gabime /pasaktesi në specifika. Keto GVJ -ja komunikoi edhe GVB, ne takimin qe u zhvillua.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Struktura e programit të studimit përmban një listë lëndësh me zgjedhje të cilat janë pjesë e kurrikulës me qëllim që të ofrojnë fleksibilitet në formimin e studentëve.</p> <p>Duke ju referuar <b>Evidencës 55</b> dhe takimeve të zhvilluara nga GVJ u vu në dukje se studentët ndjekin një plan mësimor në të cilën një pjesë e lëndëve marrin prapashitesën Turizëm por në syllabuse pasqyrohen konceptet bazë të lëndës, si psh: <i>Bazat e Kontabilitetit në turizëm</i>, syllabusi ofron baza të kontabilitetit. Në të njëjtën kohë, nga takimi me studentët dhe lektorët rezultoi se disa lëndë janë të vështira për studentët duke patur parasysh mesataren e tyre në hyrje (p.sh lënda <i>Matematikë e aplikuar në biznes</i>).</p> <p>Gjithashtu vërehet se në planin mësimor ka vetëm një lëndë e cila lidhet me eventet, kjo bie ndesh me objektivat e programit të studimit, specialistët nuk mund të formohen duke ndjekur një lëndë të vetme por një grup lëndësh të cilat i japin atyre dijet e mjaftueshme për të</p>

	<p>performuar në tregun e punës.</p> <p>Lëndët bazë në këtë program studimi duhet të jenë në përputhje me strategjinë e programit dhe objektivat e tij. Në këto kushte GVJ sugjeron që tre lëndët bazë të jenë njëra me qasje të hotelierisë, tjetra në restorante dhe e treta në evente. Duke patur këto lëndë bazë studenti është në gjendje të krijojë një kornizë të qartë mbi studimet që po ndjek.</p> <p>Përgjatë takimeve, GVJ vuri në dukje se lëndët me zgjedhje duhet të jenë më të shumta në numër dhe të jenë të karakterit të turizmit, hotelierisë dhe eventeve, kjo me qëllim që studenti të zgjedhë ato lëndë të cilat përshtaten me interesin e thellimit të dijeve të tij.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Studentët në këtë program studimi ndjekin 2 lloje praktikash, praktikën mësimore dhe praktikën profesionale. Gjatë vizitës në IAL grupit të vlerësuesve ju sqarua se këto praktika funksionojnë në dy mënyra të ndryshme. Praktika mësimore zhvillohet semestrin e dytë të vitit të parë dhe zgjat pesëmbëdhjetë (15) javë, nga tre (3) orë në javë. Pra trajtohet në formën e një lënde. Në fund profesori udhëheqës e vlerëson studentin bazuar në dokumentacionin që studenti dorëzon.</p> <p>Praktika profesionale zhvillohet në përfundim të studimeve dhe shtrihet në një hapësirë kohore prej një muaj. Kjo praktikë zhvillohet nën mentorimin e profesorëve dhe të institucionit ku zhvillohet praktika.</p> <p>Të dyja këto praktika mbajnë një peshë prej gjashtë (6) kredite, dhe kanë një pjesë të orëve të zhvilluara në auditor dhe një pjesë të orëve janë konsideruar si orë mësimore jashtë auditorit.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi II.2</b>  <b>Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” është i shpërndarë në vite dhe semestra si dhe i organizuar në kredite dhe orë mësimore në përputhje të plotë me ligjit për arsimin e lartë 80/2015 si dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018 si dhe aktet nënligjore në mbështetje të këtij ligji.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Kjo ndarje shpërndarje mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Orët në auditor dhe jashtë tij i japin studentit informacionin e nevojshëm formimin e tij dhe përgatitjen për tregun e punës.</p> <p>Në një pjesë të lëndëve kishin si prapashitesë në titullin e tyre fjalën</p>

	<p>turizëm, por në syllabus nuk kishin asnjë specifike dhe veçanti të turizmit, (psh. <i>Hyrje në ekonominë e turizmit është Hyrje në ekonomi, Marketing në turizëm është Marketing</i> etj).</p> <p>Gjatë vizitës së tij GVJ vuri në dukje se një pjesë e madhe e lëndëve të planit mësimor janë me karakter ekonomik të përgjithshëm, ndërkohë që studentët e degëve me karakter profesional kanë nevojë për lëndë të profilit të tyre. Këtu mund të përmendim faktin se për degën e studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” ka vetëm një lëndë në fushën e eventeve. GVJ gjykon se vetëm një lëndë nuk është e mjaftueshme për të formuar specialist të fushës së eventeve, sikundër programi i studimit është emërtuar.</p> <p>GVJ sygjeron që kur të mendohet rishikimi i planit mësimor, stafi përgjegjës të jetë i kujdesshëm në emërtimin e lëndëve dhe për më tepër titulli i lëndës të justifikojë përmbajtjen e syllabusit.</p> <p><i>Evidenca 54 Plani mesimor</i></p> <p><i>Evidenca_Plan Mesimor Program Profesional 2 vjecar ne MTHE</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Plani mësimor si dhe materialet mbështetëse të tij (syllabuset) japin informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e lëndës, por syllabuset nuk janë shumë të qarta në lidhje me orët që zhvillohen në auditor pasi në një pjesë të syllabuseve kreditet, orët mësimore në auditor ose orët e studimit individual nuk janë në përputhje me planin mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>GVJ vuri re se një pjesë e lëndëve në planin mësimor janë më shumë të karakterit ekonomik. GVJ sygjeron që në rishikimin e planit mësimor të këtij programi studimi në të ardhmen, t’i mëshohet më shumë përfshirjes në këtë plan i lëndëve më specifike në fushën e turizmit dhe sidomos ato në fushën e hotelierisë dhe eventeve.</p> <p>Në këtë program studimi ka një raport pothuajse të balancuar midis moduleve /aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike. Raporti <b>510</b> orë leksione /<b>654</b> seminare/ushtrime/praktikë del <b>43% me 57%</b>, por më shumë në fushën e turizmit dhe më pak në atë të hotelierisë dhe eventeve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga ana e strukturimit të kurrikulës dhe planit mësimor, ndarjes në kredite dhe orë mësimore programi i studimit mundëson arritjen e objektivave formuese.</p> <p>Për sa i përket përmbajtjes së planit mësimor në lëndë, është e nevojshme ndërhyrja dhe riorganizimi i këtij programi me qëllim nxitjen e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës. Gjatë takimit me NJSBC-në, GVJ vuri në dukje rëndësinë e hartimit të planit mësimor në bashkëpunim me bizneset dhe studentët, gjë kjo e cila do të krijonte mundësinë për një plan mësimor që i vjen në ndihmë studentëve dhe bizneseve të interesuar për të patur punonjës në këtë fushë studimi.</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b>    <b>Përmbushet</b>    <b>Përmbushet</b>    <b>Përmbushet</b></p>

<b>standardit</b>		<b>pjesërisht</b>	<b>kryesisht</b>	<b>plotësisht</b>
		<b>X</b>		

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktivitetëve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	<p>Programi i studimit në “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” përmban të dhëna të plota mbi formimin teorik dhe praktik të studentëve. Studentit i vihet në dispozicion plani mësimor si dhe syllabuset për çdo lëndë të ndjekur gjatë periudhës së formimit të tij.</p> <p>Gjatë takimeve të realizuara GVJ ju vu në vëmendje se studenti në momentin e regjistrimit ka në dispozicion planin mësimor që do të ndjekë. Ndërsa syllabuset i vihen në dispozicion në fillim të cdo lënde, kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me studentët.</p> <p><i>Evidenca 58 Rregullore e programit</i></p> <p><i>Evidenca 55 Plani mesimor sipas llojit te veprimtarise</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/ të pritshme nga punëdhënësit.	<p>Programi i studimit ka një përmbajtje më së shumti ekonomike sesa me qasje profesionale në fushën e studimit, gjë kjo e cila u vu në dukje nga GVJ edhe gjatë takimeve të zhvilluara në IAL. Duke qënë se hapja e programit të studimit është realizuar duke u mbështetur në një kërkim tregu të përgjithshëm dhe plani mësimor nuk është hartuar në bashkëpunim me bizneset e fushës profesionale GVJ mendon se nuk është e qartë pritshmëria e bizneseve dhe përmbushja e saj nga ana e studentëve.</p> <p>Duke qënë se në vitin akademik 2019-2020 janë brezi i parë i të diplomuarve në këtë program studimi, GVJ nuk mund të gjykojë në lidhje me aftësimin e këtyre studentëve nga ky program studimi dhe nëse nevojat e bizneseve plotësohen nga ky profil studentësh etj. Kjo do të mbetet të vlerësohet në vazhdim dhe do të shërbejë për të përmirësuar programin e studimit.</p> <p>Bazuar në syllabuset e vëna në dispozicion përmbajtja e lëndëve me karakter profesional i vjen në ndihmë studentëve për formimin e tyre. Lëndët në kurrikul kanë një shpërndarje e cila mundëson zhvillimin e aftësive të transferueshme nga njëra lëndë në tjetrën. Vazhdimësia e lëndëve në kurrikul mundëson përdorimin e dijeve përgjatë viteve akademike që student ndjek në programin e studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente”</p>
<b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	
<b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik,	<p>Gjatë vizitës në IAL dhe takimeve të zhvilluara, sidomos në takimin me studentët, evidentohet rëndësia e kryerjes së praktikës mësimore dhe asaj profesionale. Studentët e shikojnë mundësinë e praktikës si një mënyrë të mirë për të vënë në jetë dijet e tyre. Madje në këtë takim u vu në dukje fakti se studentët ndiejnë nevojën për praktikë në</p>

zgjdhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	të gjitha lëndët e zhvilluara.  Një pjesë e studentëve kanë zgjedhur këtë program studimi duke qënë se janë të angazhuar në fushën e turizmit, hotelerisë dhe eventeve. Por një pjesë tjetër e tyre nuk janë të angazhuar në këtë fushë dhe kanë pritshmëri më të larta për zhvillimin e praktikës dhe krijimin e mundësive të punësimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Studentët në këtë program studimi gjatë zhvillimit të praktikës janë në kontakt të vazhdueshëm me mentorin e praktikës si nga ana e departamentit dhe nga kompania ku zhvillohet praktika. Deri më tani studentët i kanë krijuar mundësitë e praktikës më së shumti bazuar në njohjet e tyre personale pasi gama e bizneseve të ofruara nga IAL-ja për zhvillimin e praktikës mësimore dhe profesionale nuk janë të fokusuara në fushën e këtij studimi. Marrëveshjet për këtë fushë studimi janë ende në proces dhe nuk kanë përfunduar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.	Institucioni ka një udhëzues të qartë të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies. Ky institucion ka ngritur struktura të posaçme të cilat monitorojnë mësimdhënien në auditor dhe jashtë tij. Procesi mësimor monitorohet nga drejtuesi i njësisë bazë, dhe nga vetë IAL-ja. Pjesë e këtij vlerësimi janë edhe studentët. Rezultatet e vlerësimit i prezantohen privatisht pedagogut.  <i>Evidenca 14 UMT Rregullore e Etikës</i> <i>Evidenca 9 UMT Rregullore e NjSBC</i> <i>Evidenca 71 FE Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës</i>
<b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike,	Format e mësimdhënies sipas Planit mësimor janë:  - Leksionet (51 kredite) 510 orë mësimore në auditor  - Seminarët (25.5 kredite) 255 orë mësimore në auditor



<p>orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ushtrimet (15.5 kredite) 155 orë mësimore në auditor</li> <li>- Detyrat e kursit (15 kredite) 150 orë mësimore në auditor</li> <li>- Praktika mesimore dhe profesionale (12 kredite) 120 orë në auditor</li> <li>- Provimi final (6 kredite) 24 orë në auditor</li> </ul> <p>Gjatë takimit me Lektorët e Departamentit të Shkencave të Administrimit u vu në dukje se një pjesë e literaturës për programin e studimit me karakter profesional nuk është ende gati, pasi profesorëve u duhet të punojnë për hartimin e tyre duke qënë se në dispozicion nuk ka literaturë të mjaftueshme për programet e studimit me karakter profesional. Literatura për këto programe studimi është më shumë në gjuhë të huaj dhe duke patur parasysh nivelin e mesatares së studentëve, profesorëve u nevojitet hartimi dhe përshtatja e leksioneve për këtë program studimi duke thjeshtësuar përmbajtjen. Leksionet e programit të studimit miratohen në department.</p> <p>Cdo vit akademik departamenti miraton paraprakisht leksionet e hapura dhe aktiviteteteve që zhvillohen. Departamenti I organizon leksionet e hapura, në të cilat studentët marrin pjesë aktive dhe marrin informacion mbi tregun e punës dhe nevojat e tij.</p> <p>Studentët ndjekin praktikën në përputhje me rregulloren e praktikës dhe shlyejnë detyrimet e tyre të praktikës me qëllim që të fitojnë numrin e krediteve. Ndjekja e praktikave mësimore është një procedurë e cila është miratuar paraprakisht në department.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Gjatë takimit me profesorët e programit të studimit GVJ mori informacion mbi mënyrën e zhvillimit të leksioneve. Profesorët punojnë me qëllim përshtatjen e dijeve për interes të grupit ku ata japin mësim, si dhe përshtasin dijen e tyre me nevojat për njohuri të grupit.</p> <p>Profesorët e përfshirë në mësimdhënie janë profesorë të specializuar në fushat ku ata japin leksion, gjë e cila i bën ata kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve.</p> <p>Për qëllime të realizimit të orëve mësimore dhe të shpërndarjes së dijeve, profesorët përdorin metoda interaktive dhe gjithëpërfshirëse. Për shembull gjuha angleze nuk zhvillohet si leksion i mirëfilltë gjuhe por i jep studentëve njohuritë bazë të komunikimit në fushën e Turizmit. Lektorë të cilët kanë shoqëruar studentët në terren, vënë në dukje rëndësinë e praktikës dhe materializimin e njohurive.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion si dhe gjatë takimit me profesorët e programit të studimit, takimit me përgjegjës të departamentit apo NJSBC u vu re se institucioni nuk ofron trajnime të mirëfillta në fushën e mësimdhënies, por për t'u ardhur në ndihmë profesorëve të rinj, departamenti mundëson ndjekjen e leksioneve të dhëna nga stafi akademik më me përvojë në mësimdhënie.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion si dhe gjatë takimit me profesorët e programit të studimit, takimit me përgjegjës të departamentit apo NJSBC u vu re se institucioni nuk ofron trajnime të mirëfillta në fushën e mësimdhënies, por për t'u ardhur në ndihmë profesorëve të rinj, departamenti mundëson ndjekjen e leksioneve të dhëna nga stafi akademik më me përvojë në mësimdhënie.</p>

	Institucioni mundëson pjesëmarrjen e stafit në projekte të shkëmbimit të profesorëve, si projektet Erasmus+, në të cilat secili prej lektorëve të programit të studimit gjatë takimit pranoi se kishte qënë të paktën një herë pjesëmarrës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion, (<a href="#">Tabela 16</a>, <a href="#">Evidenca 107</a>, <a href="#">108</a>), UMT siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi se institucioni disponon, laboratorë, klasa, zyra, biblioteka, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e këtij program studimi. Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave për infrastrukturën, GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimit e mësimin të programit të studimit.</p> <p><i><a href="#">Tabela 16 Mjediset e Fakultetit te Ekonomise, njesive baze.</a></i></p> <p><i><a href="#">Evidenca 107 FE Ambjentet për infrastrukturën të UMT FE.</a></i></p> <p><i><a href="#">Evidenca 108 FE Asete infrastrukturore, akademike UMT.</a></i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht 2 laboratorë. GVJ konstatoi laboratorët që UMT disponon me pajisjet e duhura harduerike dhe softuerike që studentëve ju nevojiten.</p> <p>Por lëndët që kanë laboratore, sipas planit mësimor, për programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" janë të pakta (vetëm lënda Njohuri informatike), për këtë arsye laboratorët nuk janë shumë të përdorshëm për këtë program studimi. Platforma "Edu4Schools", e cila është një metodë inovative që krijon mundësi për të komunikuar me studentët për aspekte të ndryshme të procesit mësimor kërkimor, përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimin, ku materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike.</p> <p>Për stafin akademik dhe administrativ ka zyra të veçanta.</p> <p><i><a href="#">Tabela 16 Mjediset e Fakultetit te Ekonomise, njesive baze.</a></i></p>

	<i>Evidenca 107 FE Ambjentet për infrastrukturën të UMT FE.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	<p>Bazuar në planet mësimore të programit, në literaturën e syllabuseve dhe gjatë bisedës me lektorët GVJ ju vu në dukje se lektorët janë duke punuar për të realizuar cikle leksionesh për studentët e këtij profili.</p> <p>Duke qënë se programi i studimit është me karakter profesional dhe studentët kanë një mesatare të ulët në hyrje stafit i ka lindur nevoja të hartojë cikle leksionesh për lëndët e këtij programi studimi. Ka vonesa në përpilimin e tyre në gjuhën shqipe, sepse nuk është realizuar ende për të gjitha lëndët, por vetëm për një pjesë të tyre.</p> <p>Literatura e cila është në dispozicion ofrohet e printuar dhe elektronike në disa raste me email dhe në disa raste e hedhur në sistemin ‘edu4-schools.com’.</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	<p>Institucioni ofron për studentët mundësinë e aksesit në bibliotekën online por gjatë takimit me studentët GVJ u informua se studentët e këtij programi studimi nuk e përdorin bibliotekën online, një pjesë e tyre dhe për shkak të njohurive të tyre teknologjike.</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	<p>Pranë UMT ka disa laboratore të teknologjisë së informacionit, dhe për lëndë dhe sidomos për tematika të veçanta për programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" mund të përdoren.</p> <p>Në takimin që GVJ pati me përfaqësues të Zyrës së këshillimit të karrierës, u theksua kujdesi që u kushtohet studentëve që në momentin e rregjistrimit duke iu ofruar çdo studenti “çantën e studentit” e cila përmban një kompjuter laptop të ri, i cili mund të përdoret deri në momentin e diplomimit.</p>			
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	<p>IAL përdor platformën ‘edu4schools’ në funksion të mësimdhënies. Kjo platformë shërben për informimin e studentëve mbi vlerësimin, oraret, shpërndarjen e informacionit, etj.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë COVID19 Universiteti Metropolitan Tirana adaptoi sisteme online të cilat u përdorën për procesin e mësimdhënies. Gjatë takimeve GVJ u informua se këto platforma kanë qënë efektive si për personelin akademik edhe për studentët. Gjithashtu personeli dhe studentët diskutuan mbi sfidat dhe vështirësitë e këtij sistemi. Kjo ka lehtësuar studentët në përdorimin e platformave online dhe në aksesin gjatë leksioneve.</p> <p><i>Evidenca 48 UMT Platforma për mësimin onlin</i></p> <p><i>Evidenca 49 UMT Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë</i></p> <p><i>Evidenca 102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies</i></p> <p><i>Evidenca 103 FE Nderfaqe classroom e një pedagogu</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

Standardi III.3	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>UMT ka ngritur struktura në nivel institucional dhe fakulteti për të promovuar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamentet, dorëzojnë në Rektorat çdo fund viti akademik, një raport vjetor, i konceptuar si një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë. Ky raport shërben për të patur një pasqyrë të fakultetit dhe për t' u përmirësuar në vazhdimësi.</p> <p>Në nivel institucional, për monitorimin e procesit të mësimdhënies një funksion të rëndësishëm ka dhe “Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë” e cila ndër detyrat e shumta që mban, ka si detyrë edhe monitorimin e procesit mësimor dhe mbledhjen e të dhënave të studentëve mbi procesin e mësimdhënies. Kjo njësi analizon të dhënat e mbledhura dhe i shpërndan ato tek përgjegjësi përkatës i njësisë bazë.</p> <p>Më pas drejtuesi i njësisë bazë ka për detyrim të shpërndaj informacionin e marrë nga pyetësorët dhe ta diskutoj atë me lektorin përkatës.</p> <p>Gjithashtu kjo drejtori ka një rol të rëndësishëm në analizimin e ndryshimeve ligjore dhe përshtatjen e tyre me planet mësimore të ofruara nga UMT. Planet mësimore për hapjen e programeve të reja, apo për ndryshimet në programet ekzistuese kontrollohen nga NJSBC për pjesën ligjore dhe për përshtatjen e tyre me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjatë takimit me NJSBC u vu në dukje se kjo njësi nuk ndërhyr në cilësinë apo në planifikimin e planit mësimor, pasi kjo është kompetencë e plotë e njësisë bazë.</p> <p><i>Evidenca 73_FE Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE</i></p> <p><i>Evidenca _Raport i Vlerësimit te Brendshem</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia kryesore Fakulteti i Ekonomisë, dhe njësi bazë Departamenti i Shkencave të Administrimit, duke u mbështetur në kontrollin e vazhdueshëm dhe masave të marra, të leksioneve të hapura të organizuara, si dhe të analizës së vazhdueshme të punës mësimore dhe kërkimit shkencor, krijon frymën e përgjegjësisë individuale të personelit akademik për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. Dekani si drejtues i fakultetit mbikqyr mbarvajtjen e veprimtarisë mësimore dhe shkencore në njësinë bazë, duke koordinuar dhe bashkëpunuar me drejtuesin e njësisë bazë.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave të Administrimit, drejton dhe kontrollon punën mësimore, nxit dhe motivon stafin akademik për përmbushjen e procesit mësimor, realizimit të detyrave dhe kërkimin shkencor (<i>rregullore Fakulteti, Neni 8, 13 &amp;14</i>).</p>

	<p>Gjatë takimit me përgjegjësin e njësisë bazë dhe anëtarët e departamentit të shkencave të administrimit GVJ ju vu në dukje se përgjegjësi luan një rol të rëndësishëm në motivimin e stafit, kontrollin e punës mësimore, kontrollin e syllabuseve dhe nxitjen e stafit për pjesëmarrje në konferenca dhe botime shkencore. Nxitja kah kërkimit shkencor është një element i cili u vu në dukje nga lektorët gjatë takimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Në tërësinë e aktiviteteve të UMT një vend të rëndësishëm zë rritja e vazhdueshme e nivelit kërkimor-shkencor të stafit akademik duke përfshirë edhe studentët në Konferenca Studentore, projekte apo inkubatorin e biznesit, me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Por Studentët e këtij programi studimi nuk janë përfshirë në aktivitete të tilla si Konferenca Studentore si pjesëmarrës por vetëm si organizatorë dhe kjo për shkak të formimit profesional të tyre dhe jo formim shkencor.</p> <p>Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit transmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Kjo gjë konfirmohet dhe në CV e stafit akademik që shikohet se në këto vitet e fundit kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Ky kualifikim i personelit akademik të Fakultetit dhe departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Për shkak të periudhës së pandemisë COVID-19, në vitin akademik 2019-2020 stafi akademik ka implementuar metodën e mësimdhënies online dhe ka ofruar për studentët mundësinë e ofrimit të leksioneve duke qënë në komunikim të vazhdueshëm me ta. Gjithashtu kjo periudhë është përdor edhe si një periudhë praktike në lëndë specifike të cilat e lejonin këtë mundësi. GVJ e mori këtë informacion gjatë zhvillimit të takimit me stafin akademik në vizitën e vlerësimit të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit e tyre.</p>	<p>Në vazhdimësi personeli akademik i Fakultetit të Ekonomisë dhe departamentit të Shkencave të Administrimit, kualifikohen brenda institucionit dhe jashtë tij në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes tryezave të rumbullakëta, diskutimeve, leksioneve të hapura, apo mobilitete të stafit.</p> <p>Këto aktivitete kanë shërbyer si trajnime për stafin akademik dhe përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe përshtatjes së metodave të reja në të. Pjesëmarrja e stafit akademik në këto aktivitete nxitet dhe motivohet nga njësi bazë, por institucioni nuk financon për to.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik në lidhje me metodat e mësimdhënies dhe u komunikua se synohet më tepër mësimdhënie në mënyrë interaktive duke aktivizuar edhe studentët gjatë leksioneve. Seminaret zhvillohen duke trajtuar përveç aspekteve teorike, raste studimesh, video etj. Sipas opinionit të stafit akademik, duke ditur edhe</p>

përgjegjëse.	niveLIN e studentëve të regjistruar në këtë program studimi, rezulton se kjo mund të jetë mënyra më e mire për mësimdhënien.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në UMT, se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e tyre. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, teste me alternativa përgjigjesh si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e Programit të studimit.</p> <p>Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së UMT realizohet nëpërmjet: angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegiumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; detyrave të kursit që lidhen me problematikën e disipline; provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës. Sistemi i vlerësimit të studentëve është i njëjtë për të gjitha programet me karakter profesional dhe programet e studimit të ofruar në UMT dhe realizohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit nga nota 1 deri në 10, ku nota 5 rezulton si notë kaluese. Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive së bashku me plotësimin e detyrimeve (detyrave të kursit) vlerësohen me 10%,</li> <li>- testimet gjatë vitit (ose provimi ndërmjetëm) me 20% dhe</li> <li>- në fund kryhet provimi përfundimtar, i cili vlerësohet me 70%. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve, që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve.</li> </ul> <p><i>Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve</i></p> <p><i>Evidenca 56 Plan Programet e lendeve viti 1</i></p> <p><i>Evidenca 56.1 Plan Programet e lendeve viti 2</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet</p>	<p>Bazuar në rregulloret e studimeve të UMT-së, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e programit të studimit, dhe rregulloren e provimeve janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për</p>

<p>në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetësuar studentit gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, për të testuar sa më realisht njohuritë dhe kompetencat e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerës të syllabusit. Gjithashtu i njeh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës.</p> <p>Grafiku i zhvillimit të provimeve hartohet nga përgjegjësi i njesisë bazë dhe miratohet nga Dekani. Studentët informohen në lidhje me datat e provimeve me anë të platformës online. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i njesisë bazë, në rastet kur ky i fundit nuk është prezent, teza miratohet nga dekani i fakultetit. Në përfundim të vlerësimit studentit njihet me rezultatin.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e studimeve të UMT-së, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetësuar studentit gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, për të testuar sa më realisht njohuritë dhe kompetencat e studentëve.</p> <p>Testimi i njohurive me shkrim bëhet me anë të sekretimit (sistemi barcode), proces i cili realizohet nën mbikqyrjen e sekretarisë mësimore, dhe garanton anonimat dhe eliminon format e ndryshme të abuzimit duke rritur transparencën.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët GVJ u informua që ata orientohen që në fillim të lëndës nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursit apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, foto, video, në orët e fundit të seminareve).</p> <p>Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë proçesit të kontrollit stafi akademik shënon pikët për çdo ushtrim si dhe tregohet i</p>

<p>kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>kujdesëm të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/modulit, tezat miratohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Rezultatet e provimit hidhen në proceverbalin e detyrimeve.</p> <p>Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda 72 orëve. Pedagogu/Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit të detyrimeve dhe dorëzimin e tij në sekretarinë mësimore. Provimet me shkrim të studentëve ruhen në departament për një periudhë gjashtë mujore pas përfundimit të sezonit të provimeve.</p> <p><i>Evidenca 120. Rregullorja e Provimeve në Fakultetin e Ekonomisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfundimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.</p>	<p><b>Vlerësimi</b></p> <p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë bazë, lëndë karakterizuese dhe plotësuese, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të menaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit.</p> <p>Bazuar në <b>Evidencën 53</b> ky program studimi ka si prioritet formimin e profesionistëve të orientuar drejt:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdorimit të teknologjive të ndryshme të komunikimit për të vepruar në sistemin informativ të sipërmarrjes turistike</li> <li>• përpunuar dhe promovuar ofertën turistike për të gjithë sistemin</li> <li>• planifikuar dhe menaxhuar veprime që optimizojnë cilësinë e shërbimeve dhe organizimin e eventeve dhe takimeve të profesionistëve në fusha të ndryshme</li> <li>• vlerësimin e burimeve dhe pasurive kulturore të territorit</li> </ul> <p>si dhe ka si synim strategjik në lidhje me studentët</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• rritjen e cilësisë së aftësisë praktik të studentëve nëpërmjet aplikimeve të metodave bashkëkohore në fushën e menaxhimit turizmit</li> </ul> <p>GVI konstatoi se Kurrikula e programit të studimit “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” ka nevojë për përmirësim. Pasi lëndët e ofruara në këtë program studimi nuk i plotësojnë objektivat e programit.</p>



	<p>Nëse marrim si shembull objektivin e fundit do të shikojmë se kurrikula e këtij programi nuk ka asnjë lëndë që të ndikojë në formimin e studentëve në vlerësimin e burimeve dhe pasurive kulturore.</p> <p>GVJ sugjeron pasurimin e kurrikulës me lëndë të profilit të cilat i vijnë në ndihmë studentit në formimin e tij Në këtë kurrikul ka vend për përfshirjen e lëndëve si <i>Menaxhimi i shërbimeve</i>, <i>Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit</i>, apo zëvendësimi i lëndës <i>Menaxhimi i burimeve njerëzore</i> me lëndën <i>Karriera në turizëm</i>, zëvendësimi i lëndës <i>Etikë biznesi në turizëm</i> me lëndën <i>Etika dhe përgjegjësia sociale</i>, etj.</p> <p><i>Evidenca 55 Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se modulet/lëndët janë në përputhje me zbatimin e VKM 41/2018 të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmyllëse.</p> <p>Bazuar në <b>Evidencën 55</b> dhe në takimin me studentët dhe lektorët e këtij programi studimi, programi garanton një sërë njohurish të përshtatshme për tregun e punës por GVJ mendon se ka nevojë për përmirësime me qëllim që specialistët e formuar në këtë fushë të jenë eficientë në tregun e punës dhe të pajisur me njohuritë e nevojshme për t'u përballur me këtë treg (mënyra e përmirësimit të njohurive është sqaruar në kriterin 1 të këtij standardi).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që t'i pajisin studentet me aftësi për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit përmban zhvillimin e praktikës mësimore në dy periudha të ndryshme, në vitin e parë dhe në vitin e dytë. Hartimi i planit mësimor është bërë në mënyrë të tillë që t'i japë hapësirë studentit për të zhvilluar praktikën mësimore dhe atë profesionale. Praktika profesionale zhvillohet për pesë javë pa ndërprerje, për qëllim të realizimit të praktikës mësimore në semstrin e dytë të vitit akademik, studenti e zhvillon programin mësimor të shtrirë në dhjetë (10) javë.</p> <p>Gjatë takimit me lektorët GVJ ju sqarua se gjatë periudhës së pandemisë realizimi i praktikave mësimore ishte një sfidë dhe jo të gjithë studentët mundën ta realizonin atë. Studentët gjithashtu treguan eksperiencën e tyre në realizimin e praktikave mësimore duke vënë në dukje se disa prej tyre i realizuan në bizneset e tyre private apo në kompani ku nuk shpenzuan maksimalisht kohën e praktikës mësimore.</p> <p>Ky organizim i kurrikulës u jep mundësinë studentëve për t'i zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.</p> <p>Institucioni ka projekte në të cilat përfshihen studentët dhe ka mobilitete të shumta, por studentët e këtij programi studimi nuk janë përfshirë ende në këto projekte.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e</p>	<p>Vlerësimi i studentit në fund të një lënde të ndjekur bëhet duke u bazuar në:</p>

<p>shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrje (10%)</li> <li>• Provim i ndërmjetëm; (20%)</li> <li>• Detyrë kursi; (10%)</li> <li>• Provim përfundimtar (60%)</li> </ul> <p>Bazuar në rregulloren e IAL-së këto element kanë peshën e tyre me qëllim që studenti të ketë një vlerësim të vazhdueshëm në lidhje me lëndën e ndjekur.</p> <p>GVJ mendon se kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur një vlerësim të drejtë të studentit dhe e nxit atë të angazhohet në të gjithë elementët e vlerësimit.</p> <p><i>Evidencë_Tabela 15 Format e kontrollit te njohurive</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion GVJ konstaton se IAL-ja ka hartuar dhe ndjek veprimtarinë e studentit deri në përmbylljen e studimeve të tij. Studenti është nën vëmendjen e lektorëve dhe institucionit për përmbushjen e detyrimeve dhe mbylljen me sukses të procedurave të posaçme të hartuara për realizimin e diplomimit.</p> <p>Diplomimi i studentëve bazohet në rregulloren e programit të studimit Kreu VI Neni 26. Por ky nen nuk ka detaje të mjaftueshme mbi procedurën e diplomimit, dokumentat që duhet të dorëzohen, hartimin e temës së diplomës (në rast se studenti zgjedh të hartojë një temë), gjithashtu në këtë nen nuk ka detaje mbi provimin e diplomimit (në rastin kur studenti diplomohet me provim). Për këtë arsye, GVJ sugjeron hartimin e një rregullore të veçantë për programin e studimit.</p> <p>Gjatë takimit të GVJ me sekretarinë u konstatua se institucioni ruan në mënyrë të rregullt regjistrat zyrtar të studentëve. Sekretarisë ju kërkua vënia në dispozicion e regjistrat të studentëve, e cila ishte plotësuar në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka një zyrë Alumni e cila mban të dhëna të studentëve të diplomuar dhe kujdeset për gjurmimin e rrugëtimit të tyre.</p> <p><i>Evidenca 58 Rregullore e programit</i></p> <p><i>Evidenca 124 Dokumentacion i praktikës per programin e studimit</i></p> <p><i>Evidenca 30 UMT Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Në përfundim të përmbushjes së detyrimeve kurrikulare studentët e këtij programi studimi nuk përgatisin një temë diplome por zhvillojnë një testim përmbyllës, i cili ka si funksion vlerësimin e dijeve të marra nga studentët. Kjo zgjedhje është bërë për faktin se mesatarja në hyrje e studentëve është e ulët dhe dijet e tyre nuk cilësohen të mjaftueshme për hartimin e një teme diplome. Për këtë arsye për t'u ardhur në ndihmë zhvillohet ky lloj testimi.</p> <p>Gjatë takimeve të zhvilluara GVJ sugjeroi angazhimin e studentëve në hartimin e temave të diplomës, duke përdorur tema praktike të fushës. GVJ e konsideron shumë të rëndësishme anagazhimin e studentit dhe</p>

	paraqitjen e ideve të tij. Zhvillimi i këtyre temave e ndihmon studentin të mendojë për fushën në të cilën dëshiron të fokusohet dhe të ketë një të ardhme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar (<a href="#">Evidenca 29</a>), RVB si edhe gjatë vizitës në institucion, rezulton se UMT, ka një tërësi rregulloresh dhe dokumentash të mbështetur në bazën ligjore në lidhje me procedurat e rekrutimit të stafit akademik. GVJ gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin e burimeve njerëzore, konsultoi një praktikë konkrete, të zbatimit të këtyre procedurave. Megjithatë, stafi i burimeve njerëzore, shprehet se prej tyre bëhet vetëm seleksionimi paraprak i kandidatëve, pasi ky staf nuk mund të marrë vendime për rekrutimin. Fazat e tjera të rekrutimit, deri në përzgjedhjen e kandidatëve, bëhet nga dekani dhe drejtuesit e UMT.</p> <p>Stafi i burimeve njerëzore shprehet se UMT zbaton rregulloret e rekrutimit si dhe përzgjidhen më të mirët (duke parë institucionet ku kandidatët kanë kryer studimet universitare dhe ato pas universitare, notat në lëndë përkatëse etj) jo vetëm në fushën akademike por edhe në ekspertizën profesionale të tyre.</p> <p>GVJ, konstaton se UMT ka një procedurë në të cilën identifikohen, kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit, sipas ligjeve në fuqi. Shpallja e vendeve vakante dhe kriterëve të përgjithshme dhe specifike për kandidatët bëhet në faqen zyrtare të UMT ose në media të tjera.</p> <p><a href="#">Evidenca 29 UMT Udhëzim mbi politikën e punësimit të stafit akademik në UMT</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë	GVJ konstatoi se UMT, në lidhje me programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente", disponon të dhënat për çdo semestër, për çdo vit akademik, të stafit

<p>anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësitor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>akademik që përfshihet në program. Në këto të dhëna përcaktohen edhe lëndët që mbulon secili anëtar i stafit akademik si dhe statusin e tij (<a href="#">Evidenca 69</a>. Personi përgjegjës për organizimin e programit të studimit (kordinatori) ka gradën shkencore “Master i shkencave” (<a href="#">Evidenca 81</a>).</p> <p>Duke ju referuar edhe dokumentacionit (<a href="#">Evidenca 70</a>), GVJ, nga konsultimi i dosjeve të stafit të programit, rezulton se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore (1 PAK dhe 1 PAE), gjendet dokumentacioni si, kontratë e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, formular i vetdeklarimit ose vërtetim i gjendjes gjyqësore, raport mjeko-ligjor, CV, çertifikata kualifikimesh apo pjesmarrjesh në konferenca etj</p> <p><i>Evidenca 81 UMT Vendim për përcaktimin e koordinatëve të programeve studimore në FE.</i></p> <p><i>Evidenca 66 FE Lista e Plotë e peronelit akademik me kohë të plote, me kohë të pjesshme FE.</i></p> <p><i>Evidenca 69 Te dhena per mbulimin e lendeve me personel akademik.</i></p> <p><i>Evidenca 67 FE Lista e plotë e peronelit akdamik dhe administrativ.</i></p> <p><i>Evidenca 70 FE Lista e dokumentave per dosjen personale të pedagogut.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga i gjithë dokumentacioni është evidente që Institucioni dëshmon një angazhim të plotë të burimeve njerëzore, për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p>Referuar dokumentave që shoqërojnë RVB-në (Tabela 7), stafi akademik i angazhuar në program për <b>vitin akademik 2019-2020</b> përbëhet nga <b>22</b> pedagogë nga ku <b>13</b> pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Prof. Dr,</li> <li>- 1 Prof. Assoc.</li> <li>- 6 Dr</li> <li>- 4 Msc,</li> </ul> <p>dhe <b>9</b> pedagogë me kontratë (PAK)</p> <p>Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion (Tabela 12), GVJ konstaton që pjesa më e madhe e orëve mësimore të këtij programi studimi për vitin akademik 2019-2020 mbulohet nga staf akademik me kohë të plotë. Konkretisht 68% të orëve mësimore të këtij programi, mbulohen nga staf akademik PAE dhe 32% të orëve mësimore mbulohen nga stak akademik PAK.</p> <p>Në <b>vitin 2018-2019</b> janë angazhuar gjithsej <b>11</b> pedagogë nga ku <b>9</b> pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Prof. Assoc.</li> </ul>

	<p>- 7 Dr, - 1 Msc,</p> <p>dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK).</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje (Tabela 4, tabela 6.1, tabela 12.1) është 80% PAE /20% PAK (viti akademik 2018-2019 është viti i parë i fillimit të këtij programi studimi).</p> <p><i>Tabela 7 Te dhena permbledhese te stafit akademik sipas kualifikimit..</i></p> <p><i>Tabela 4, ngarkesa totale 2018-2019.</i></p> <p><i>Tabela 6.1, Cilesia e stafit akademik, 2018-2019.</i></p> <p><i>Tabela 12 Plani mesimor i lidhur me personelin akademik perkates.</i></p> <p><i>Tabela 12.1, Plani mesimor i lidhur me stafin akademik, 2018-2019.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga takimet me stafin akademik, rezulton se UMT, organizon leksione të hapura për metodat inovative të mësimdhënies, por deri me tani per lektoret e ketij programi studimi nuk ka patur trajnime te mirefillta. Në faqen e internetit të institucionit pasqyrohen aktivtete që shërbejnë për nxitjen dhe inkurajimin e punës në të ardhmen. Platforma "Edu4Schools", e cila është një metodë inovative që krijon mundësi për të komunikuar me studentët për aspekte të ndryshme të procesit mësimor kërkimor, përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësim, ku materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike.</p> <p>Gjithashtu, bazuar në dokumentacion (<a href="#">Evidence 48</a>) por edhe gjatë takimit me stafin akademik dhe përgjegjësin e departamentit në institucion, GVJ, konstaton platformën për mësimin online për periudhën e Covid 2019 shoqëruar edhe me udhëzimin mbi mësimdhënien në distancë (<a href="#">Evidenca 49</a>).</p> <p>Gjatë vizitës që GVJ pati në UMT, stafi akademik u shpreh se kanë patur mbështetje të vazhdueshme nga institucioni për kërkimin shkencor. Sipas tyre, respektohet vjetërsia në punë për trajnimet apo edhe mbështetja financiare për pjesëmarrje në aktivtete, apo projekte. Sipas stafit të UMT, çdo anëtar i stafit akademik, ka marrë pjesë të paktën një here në mobilitetet Erasmus, për shkëmbim stafi për trajnim apo mësimdhënie.</p> <p>Stafi akademik i programit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" shprehet se ka mirëkuptim dhe frymë bashkëpunimi mes tyre dhe institucionit.</p> <p><i>Evidenca 48 UMT Platforma për mësimin online.</i></p> <p><i>Evidenca 49 UMT Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>UMT siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.</p> <p>Rezulton se institucioni disponon, laboratorë, klasa, zyra, biblioteka, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e këtij program studimi. Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave për infrastrukturën, (<i>Evidenca 107</i>), GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimit të programit të studimit. Leksionet dhe seminarët, zhvillohen në klasat që i përkasin Fakultetit të Ekonomisë, dhe po ashtu edhe laboratorët e përdoruar. Institucioni disponon 3,9 m<sup>2</sup> për student por duke qenë se mësimi bëhet në dy fasha orari, e plotëson kërkesën ligjore për ofrimin e kapaciteteve prej minimumi 5 m<sup>2</sup> për student (Evidenca 34).</p> <p><i>Evidenca 107 FE Ambjentet për infrastrukturën të UMT FE.</i></p> <p><i>Evidenca 34 Raporti MASR mbi çertifikimin e kuotave të pranimit në UMT, viti akademik 2019-2020.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht 2 laboratorë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi laboratorët që UMT disponon me pajisjet e duhura harduerike dhe softuerike që studentëve ju nevojiten. Por lëndët që kanë laboratore, sipas planit mësimor, për programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" janë të pakta (vetëm lënda Njohuri informatike), për këtë arsye laboratorët nuk janë shumë të nevojshëm dhe të përdorshëm për këtë program studimi.</p> <p>GVJ, sugjeron shtimin e oreve të laboratorëve dhe përdorimin e tyre për disa lëndë. Psh për lëndën <i>Bazat e kontabilitetit në Turizëm</i>, mund të aplikohet përdorimi i softuareve për mbajtjen e llogarive kontabël, ose për lëndë që kanë lidhje me agjensitë turistike, mund të përdoren softuare për menaxhimin e biletave etj.</p> <p>GVJ, gjykon se në këtë mënyrë programi i studimit bëhet më praktik dhe aplikativ sesa teorik.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për	<p>Sallat e leksioneve dhe seminareve për këtë program studimi janë të pajisura me kompjuter dhe vidioprojektor, si edhe me tabela për të mundësuar një proces mësimdhënie efektiv.</p> <p>Laboratorët që UMT disponon dhe që përdoren edhe për këtë</p>

plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	program studimi, janë të pajisura me pajisjet e duhura harduerike dhe softuerike që studentëve ju nevojiten			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Pranë UMT ka laboratore të teknologjisë së informacionit, por programi i studimit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" ka aktualisht vetëm një lëndë ku mund të përdoret laboratori i IT (vetëm për lëndën Njohuri informatike).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Praktika profesionale zhvillohet pranë bizneseve me të cilat UMT ka marrëveshje bashkëpunimi. Praktika zhvillohet një ditë në javë, në vitin e parë, semestri i dytë (6 kredite) dhe një muaj në vitin e dytë, semestrin e dytë (6 kredite). Studentët që kanë bizneset e tyre familjare e zhvillojnë praktikën pranë këtyre bizneseve, ndërsa të tjerët e zhvillojnë në kompanitë (hotele, resorte, agjensi turistike etj), që institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Në fund të praktikës, studenti vlerësohet për periudhën e praktikës sipas aktiviteteve përkatëse nga përfaqësuesi i kompanisë ku është zhvilluar praktika.  Për vitin akademik 2019-2020, përgjegjësi i departamentit, u shpreh se kishte vështirësi për realizimin e praktikës profesionale, kjo për shkak të Codiv 2019. Kompanitë e kishin të vështirë të pranonin studentë për praktikë dhe pjesa më e madhe e tyre e kishte realizuar praktikën në bizneset familjare ose në biznese të tjera njothurve dhe të afërme të tyre.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Për realizimin normal të të gjithë procesit mësimor, UMT vë në dispozicion të studentëve pa pagesë bibliotekën mësimore, në mënyrë që të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të studentëve dhe mundësi të barabartë për të gjithë studentët pavarësisht se në programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente", ka numër të vogël studentësh. Biblioteka mund të përdoret nga studentët pa kufizime gjatë orarit zyrtar që biblioteka qëndron e hapur. Biblioteka disponon vende të mjaftueshme për studentët dhe u ofron atyre mundësinë për të studjuar, për të përdorur literaturën mësimore bazë apo ndihmëse duke përdorur kompjuterat që biblioteka disponon ose kompjuterat personalë, të vënë në dispozicion të studentëve nga institucioni në fillim të periudhës të studimit pranë UMT.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e	Bazuar në RVB, në dokumentacionin ( <a href="#">Evidenca 109</a> ) e vënë në

<p>pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>dispozicion nga institucioni si edhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën ekonomisë. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në bibliotekë disponohet literatura e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka vende leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore.</p> <p><i>Evidenca 109. FE Relacion biblioteke dhe laboratore informatike UMT FE.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Përveç bibliotekës fizike, UMT disponon edhe bibliotekën online (LSM) e cila disponon një mori titujsh që përdoren për literaturë ndihmëse. Student ka akses në revista shkencore, libra dhe botime të lidhura me fushën e tij të interesit. Biblioteka pajiset në mënyrë të vazhdueshme me botime periodike si dhe siguron akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë.</p> <p>Këto material janë në dispozicion të të gjithë studentëve dhe mund të përdoren në cdo kohë prej tyre.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Bazuar në RVB si edhe në dokumentacionin (<i>Evidenca 22, 23</i>) e paraqitur nga institucioni, UMT ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë në vend dhe jashtë si edhe anëtarësime në rrjete në të cilat grupet e interesit janë stafi akademik dhe studentët.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur por edhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UMT ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani si edhe është në bisedime me kompani të tjera në fushën e turizmit, për të siguruar në këtë mënyrë mundësinë për praktikën profesionale si edhe intershipte për studentët e programit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente". Këto evidence, GVJ, ju vunë në dispozicion pas vizitës në institucion (<i>Dokumentacion shtesë</i>).</p> <p>Gjithashtu UMT ka lidhur kontratë me shtëpinë botuese McGraw Hill për të disponuar një sërë titujsh librash dhe botimesh të cilat përdoren si literature bazë dhe ndihmëse për programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimit në rrjete totale.</i></p> <p><i>Evidenca 23 UMT Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.</i></p> <p><i>Dokumentacion shtesë.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe në RVB evidentohet se UMT bën një parashikim të kostove financiare për një cikël të plotë studimi.</p> <p>Gjithashtu institucioni bën një auditim të përvitshëm nga auditues të jashtëm ligjor për të gjithë aktivitetin financiar të institucionit (<i>Evidenca 129</i>), sikurse edhe harton pasqyrë të të ardhurave në nivel fakulteti për 3</p>



<p><b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>vite (Tabela 18).</p> <p>Nga RVB si edhe dokumentacioni (Evidence 129, Tabela 18) i vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konstaton se të dhënat financiare të hartuara janë në nivel institucioni dhe fakulteti por jo për program studim.</p> <p><i>Tabela 18 Te ardhurat dhe financimet 3 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidenca 129 FE Evidencë Auditimi Financiar.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Për programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" bazuar në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tij mbështetëse, departamenti i Shkencave të Administrimit harton dhe miraton kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi. Këto kriteret bëhen publike në RASH dhe në faqen zyrtare të UMT (Evidenca 36). Kriteri kryesor për këtë program studimi me karakter profesional është që kandidatët të kene përfunduar me sukses gjimnazin ose shkollat profesionale.</p> <p>Për të ndjekur rrugëtimin e studentëve dhe për t'u siguruar atyre mbështetje UMT në strukturën e tij ka edhe Zyrën e këshillimit të karrierës (Evidenca 77). Gjatë takimit që GVJ pati me përfaqësues të kësaj zyre, ata u shprehën se këshillimi i studentëve fillon që me kandidatët që duan të zgjedhin një program studimi pranë UMT. Gjatë takimeve të tilla përfaqësuesit e kësaj zyre informojnë në detaje për programet e studimit që UMT ofron si edhe i orienton dhe këshillon kandidatët për programet e studimit në lidhje me detajet e programit të studimit si edhe me mundësitë e punësimit. Informimi i kandidatëve për programet e studimit bëhet gjithashtu edhe në takimet e organizuara në kuadër të ditëve të informimit për gjimnazistët për programet e studimit.</p> <p><i>Evidenca 36 UMT Publikimet në ëeb të UMT të njoftimeve për pranimet.</i></p> <p><i>Evidenca 77 FE Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për programet e studimit pranë UMT, bëhen publike çdo vit dhe kandidatët e interesuar mund të gjejnë informacion në lidhje me to në faqen e ueb të institucionit, duke kontaktuar me Zyrën e këshillimit të karrierës apo edhe në ditët e hapura</p>

<p>programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>të informimit që organizohen nga institucionet e arsimit universitar. Këto kritere bazohen gjithashtu në statutin dhe rregulloren e institucionit. (Evidenca 1 dhe 2)</p> <p><i>Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.</i></p> <p><i>Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, nga RVB por edhe nga takimi që GVJ pati me drejtuesit, stafin akademik si edhe studentët e programit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" konstatoi se informimi në lidhje me lëndët që zhvillohen, ndarjen e krediteve sipas veprimtarive formuese apo edhe detyrimet e lëndës bëhen të ditura nga pedagogu i lëndës në fillim të cdo semestri. Gjithashtu bëhet e ditur edhe mënyra e vlerësimit (Tabela 15) për çdo lëndë sipas syllabusit të miratuar në departament.</p> <p>Sipas stafit akademik dhe drejtuesve, numri i vogël i studentëve në programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" e bën më të lehtë komunikimin me studentët apo edhe orientimin e tyre për praktikën profesionale.</p> <p><i>Evidenca 54 Plani mesimor.</i></p> <p><i>Evidenca 124 Dokumentacion i praktikës per programin e studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 55 Plani mesimor sipas llojit te veprimtarise.</i></p> <p><i>Tabela 15 Format e kontrollit te njohurive.</i></p> <p><i>Tabela 5 Institucionet dhe organizatat bashkepunuese ne rang programi per praktikat profesionale.</i></p> <p><i>Evidenca 75 UMT Lista e marrëveshjeve të bashpunimit në procesit FE.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Studentët e programit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Studenti mund të terheqë planin mësimor, strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra pranë departamentit apo edhe duke kontaktuar me kordinatorin e programit të studimit, në faqen ueb, në takim me stafin akademik etj.</p> <p>Ky informacion publikohet edhe në broshurat, takimet apo edhe ne faqen zyrtare ueb të UMT. (<a href="http://www.umt.edu.al">www.umt.edu.al</a>)</p> <p><i>Evidenca 54 Plani mesimor.</i></p> <p><i>Evidenca 53 Te dhena te pergjithshme per programin e studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 56 Plan Programet e lendeve viti 1.</i></p> <p><i>Evidenca 56.1 Plan Programet e lendeve viti 2.</i></p> <p><i>Evidenca 58 Rregullore e programit</i></p> <p><i>Evidenca 80 FE Java e orientimit FE.</i></p> <p><i>Evidenca 79 UMT Guida e studentit.</i></p>

	<i>Evidenca 117 UMT Faqa WEB dhe rrjetet sociale.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ, bazuar në dokumentacion, konfirmon se institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik dhe ndihmes, sikurse edhe në faqen web të institucionit. Studentët gjithashtu informohen në fillim të vitit akademik, edhe për ambientet që do të përdoren për zhvillim e procesit mësimor (sallat e leksionit, seminarit, laboratorët etj).  <i>Evidenca 54 Plani mesimor.</i> <i>Evidenca 124 Dokumentacion i praktikës per programin e studimit.</i> <i>Evidenca 55 Plani mesimor sipas llojit te veprimtarise.</i> <i>Evidenca 79 UMT Guida e studentit</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit bëhet i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet postës elektronike dhe nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të UMT. Platforma edu4school mundëson që pavarësisht distancës, studentët të kenë informacion dhe akses në lidhje me materialet e lëndëve mësimore, detyrimet e lëndës, komunimi për notën etj. Kjo platformë shërben si mënyrë komunikimi për çdo problematikë midis studentëve dhe institucionit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet si dhe diplomimet në strukturat përkatëse. Këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore.  Platforma edu4school mundëson që pavarësisht distancës, studentët të kenë informacion dhe akses në lidhje me materialet e lëndëve mësimore, detyrimet e lëndës, komunimi për notën etj. Kjo platformë shërben si mënyrë komunikimi për çdo problematikë midis studentëve dhe institucionit.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të	Gjatë takimit që GVJ pati në institucion konstatoi se informacioni për stafin akademik dhe ndihmës akademik disponohej nga departamenti por edhe nga zyra e burimeve njerëzore e cila dispononte gjithashtu informacion edhe për personelin administrative ( <i>Evidenca 70</i> ). Departamenti mban informacion në lidhje me aktivitetin shkencor të secilit prej stafit akademik si edhe performancën e tyre.

<p>angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Këto të dhëna rezultuan të jenë kryesisht manual dhe nuk ka një system informacioni për të mbajtur të dhënat në lidhje me stafin akademik dhe personelin administrative.</p> <p>GVJ sygjeron një system për menaxhimin e informacionit për stafin akademik jo vetëm actual por edhe atë në vite.</p> <p><i>Evidenca 70 FE Lista e dokumentave per dosjen personale të pedagogut.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit që siguron akses për studentët e programit është platforma edu4school. Platforma edu4school mundëson që pavarësisht distancës, studentët të kenë informacion dhe akses në lidhje me materialet e lëndëve mësimore, detyrimet e lëndës, komunimi për notën etj. Kjo platformë shërben si mënyrë komunikimi për çdo problematikë midis studentëve dhe institucionit. Referuar takimit me studentët, rezulton se studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre personale në platformën edu4school, kanë akses në informacionin në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive.</p> <p>GVJ referuar rregullores së UMT, konstaton se të dhënat për studentët ruhen në formë manualë dhe në regjistra elektronik. Gjatë vizitës në institucion, GVJ ju vu në dispozicion nga sekretaria mësimore regjistri manual i studentëve të programit “Menaxhim në Turizmës, Hoteleri dhe Evente”.</p> <p>Notat e studentëve në përfundim të lëndës pra nota e provimit hidhet në sistem nga pedagogu i lëndës. Notat gjithashtu hidhen në regjistrin manual nga sekretaria.</p> <p>GVJ në takimin me sekretarinë, ju komunikua se procesverbalet e provimeve mbahen në sekretarinë mësimore dhe më pas arshivohen në zyrën e arkivës së përhershme ku ruhen duke u bazuar në legjislaturën përkatëse.</p> <p>Referuar takimit të zhvilluar me stafin e burimeve njerëzore, rezulton se zyra e burimeve njerëzore administron të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrative. Këto të dhëna rezultuan të jenë kryesisht manuale.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ pati në institucion me stafin akademik si edhe me studentët e programit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizmë, Hoteleri dhe Evente" u konstatua se komunikimi apo shkëmbimi i informacionit ndërmjet stafit dhe studentëve kryhet nëpërmjet email-it si edhe nëpërmjet platformës edu4school. Platforma edu4school përdoret për mësimdhënien, për vendosjen e materialeve nga ana e stafit akademik, mbajtja e mungesave, për komunikim midis stafit akademik dhe studentëve etj. Gjithashtu për pjesën e mësimdhënies online përdoret edhe go to meeting (<i>Evidenca 48</i>) dhe classroom (<i>Evidenca 103</i>) të cilat u përdorën për procesin e mësimdhënies online gjatë periudhës Covid-19 (<i>Evidenca 49</i>).</p> <p><i>Evidenca 49 UMT Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.</i></p>

	<i>Evidenca 103 FE Nderfaqe classroom e një pedagogu.</i> <i>Evidenca 48 UMT Platforma për mësimin online.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Platforma edu4school i mundëson titullarëve si edhe organeve drejtuese të institucionit të monitorojnë në kohë reale zhvillimin e aktivitetit mësimor (sidomos në rastin kur mësimi u zhvillua online)			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen ueb të institucionit, jepet informacion në gjuhën shqipe dhe angleze, në lidhje me programet e studimit, personelin akademik apo edhe aktivitetet e ndryshme të UMT. Madje në faqen ueb bëhen publike edhe lajmërimet për vendet vakante për stafin akademik apo edhe atë administrativ.  Gjithashtu një pjesë e këtyre informacioneve bëhen publike në mediat sociale ku UMT është aktive ( <i>Evidenca 117</i> ).  <i>Evidenca 117 UMT Faqa WEB dhe rrjetet sociale.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në përcaktimin e kriterëve pranuese të programit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente", institucioni ndjek të njëjtën praktikë që zbatohet edhe për programet e tjera të studimit. Proceduarit dhe kriteret e pranimit në programit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e institucionit ( <i>Evidenca 1, evidenca 2, evidenca 58</i> ).  <i>Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.</i>  <i>Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.</i>

	<i>Evidenca 58 Rregullore e programit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për çdo student. Të gjitha procedurat e shoqerojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e institucionit si edhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Shpallja e fituesve për këtë program studim bazohet në udhëzimet e MASR si përsa i përket afateve ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UMT.</p> <p><i>Evidenca 58 Rregullore e programit</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Çdo fillim viti akademik, njësia bazë, në rastin e programit të studimit programit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente", propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve. Kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik të UMT.</p> <p>Nga takimi i GVJ me stafin e angazhuar në programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" pedagogët u shprehën se kandidatët e interesuar mund të gjejnë informacion në lidhje me to në faqen e ueb të institucionit, duke kontaktuar me Zyrën e këshillimit të karrierës apo edhe në ditët e hapura të informimit që organizohen nga institucionet e arsimit universitar.</p> <p>Në dosjen e programit të studimit në fjalë paraqiten në mënyrë të detajuar, studentët potencialë, objektivat e formimit si edhe punësimi i mundshëm i tyre.</p> <p><i>Evidenca 58 Rregullore e programit</i></p> <p><i>Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.</i></p> <p><i>Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i></p> <p><i>Evidenca 117 UMT Faqa WEB dhe rrjetet sociale.</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit, stafin si edhe me koordinatoren e programit u konstatua se studentët kandidatë për këtë program studimi informohen në mënyrë të vazhdueshme për programin e studimit, objektivat e tij si dhe kompetencat e përfituara në përfundim të tij.</p> <p>Procedurat e kalimit nga njëri vit në tjetrin përcaktohen në rregulloren e UMT (<i>Evidenca 2</i>) si edhe në rregulloren e programit të studimit (<i>Evidenca 58</i>).</p> <p><i>Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i></p> <p><i>Evidenca 58 Rregullore e programit</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e	Rregullorja e institucionit, rregullorja e programit të studimit sikurse edhe plani mësimor dhe mënyrat e vlerësimit i vihen në dispozicion

<p>procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>kandidatëve që dëshirojnë të ndjekin këtë program studimi.</p> <p>Vetëm nëse kandidatët janë dakort me procedurat si edhe plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara për të filluar këtë program studimi, nënshkruhet kontrata e studimit midis kandidatit dhe institucionit.</p> <p><i>Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i></p> <p><i>Evidenca 58 Rregullore e programit</i></p> <p><i>Tabela 15 Format e kontrollit te njohurive.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" është i disponueshëm në faqen zyrtare ueb të institucionin. Gjithashtu të gjithë të interesuarit mbi këtë program studimi mund të sigurojnë informacion më të detajuar pranë Zyrës së këshillimit të karrierës. Informacion gjithashtu në lidhje me këtë program studimi jepet për të interesuarit dhe maturantët në ditët e hapura të informimit për institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>Në takimin që GVJ pati me përfaqësues të Zyrës së këshillimit të karrierës, u evidentua se synimi në të ardhmen është lidhja me gjimnazet profesionale të hoteleri-turizmit për të patur në të ardhmen studentë potenciale këtë target gjimnazistësh.</p> <p><i>Evidenca 117 UMT Faqa WEB dhe rrjetet sociale.</i></p> <p><i>Evidenca 77 FE Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT.</i></p> <p><i>Evidenca 78 FE Aktivitetet e Zyrë së Karrierës.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Në takimin që GVJ pati me studentët si edhe stafin akademik si edhe bazuar në RVB, konstatoi se informacioni mbi përmbajtjen e çdo lënde si edhe detyrimet dhe mënyra e vlerësimit është i detajuar në syllabusin e të gjitha moduleve të programit të studimit. Stafi gjithashtu informon studentët në javën e parë të fillimit të mësimin për detajet dhe literaturën bazë dhe mbështetëse.</p> <p><i>Evidenca 56 Plan Programet e lendeve viti 1.</i></p> <p><i>Evidenca 56.1 Plan Programet e lendeve viti 2.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se, Institucioni nëpërmjet përgjegjësit të departamentit si edhe pedagogut mbikqyrës për praktikën</p>

<p>në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>profesionale vë në dijeni studentët në lidhje me programin e praktikës, detyrimet e praktikës, si edhe kohën e zhvillimit të saj dhe kompanitë ku do të zhvillohet praktika. Praktika për programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" zhvillohet një ditë në javë (të premtë) në vitin e parë, semestrin e dytë dhe 1 muaj në vitin e dytë semestrin e dytë.</p> <p>Në takimin që GVJ pati me drejtuesin e departamentit të menaxhimit, si edhe në dokumentacionin shtesë që u kërkua në lidhje me dosjen e praktikës për studentët u evidentua se kjo dosje duhet të ishte më e plotë.</p> <p>GVJ sygjeron që në dosjen e praktikës, duhet të ketë kontratë praktike me kompanitë që institucioni nuk ka marrëveshje bashkëpunimi. Programi i praktikës duhet të jetë më shpjegues dhe relacioni i praktikës duhet të jetë më narrative.</p> <p>GVJ sygjeron edhe mbrojtjen e praktikës nëpërmjet një prezantimi dhe vlerësimin e saj me notë nga një komision.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit (<a href="#">Evidenca 58</a>), syllabuset e lëndëve (<a href="#">Evidenca 56; 56.1</a>), si dhe nëpërmjet takimeve me stafin akademik dhe ndihmes, sikurse edhe në faqen ueb të institucionit (<a href="#">Evidenca 117</a>).</p> <p><a href="#">Evidenca 58 Rregullore e programit</a></p> <p><a href="#">Evidenca 117 UMT Faqa WEB dhe rrjetet sociale.</a></p> <p><a href="#">Evidenca 56 Plan Programet e lendeve viti 1.</a></p> <p><a href="#">Evidenca 56.1 Plan Programet e lendeve viti 2.</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit bëhet i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet postës elektronike dhe nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të UMT. Platforma edu4school mundëson që pavarësisht distances, studentët të kenë informacion dhe akses në lidhje me materialet e lëndëve mësimore, detyrimet e lëndës, komunimi për notën etj. Kjo platformë shërben si mënyrë komunikimi për gjithçka midis studentëve dhe institucionit.</p> <p><a href="#">Evidenca 117 UMT Faqa WEB dhe rrjetet sociale.</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
-----------------	------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Programi me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" ka brezin e parë të studentëve në vitin akademik 2018-2019 të cilët diplomohen në vitin akademik 2019-2020.</p> <p>Në përgjithësi në nivel institucioni, të dhënat e të diplomuarve në vite si edhe historiku i punësimit të tyre mbahen në zyrën e ALUMNI (<a href="#">Evidenca 82</a>). Për programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" nuk ka ende student të diplomuar.</p> <p><i>Evidenca 82 UMT Rrjeti Alumni dhe aktivitetet.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ, me sekretarinë mësimore, <a href="#">si edhe në dokumentacion (Tabela 21)</a> u evidentua se Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet si dhe diplomimet në vite.</p> <p>Duke konsideruar se programi me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" ka filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2018-2019, nuk është e mundur që të ndërtohen raporte krahasuese mbi cilësinë e studentëve.</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019 rezultojnë të regjistruar 14 studentë (mesatarja në hyrje -5.76)</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020 rezultojnë të regjistruar 24 studentë, nga të cilët 2 janë çrregjistruar (mesatarja në hyrje - 6.13)</p> <p>Për cdo student sekretaria mësimore disponon dosjet e studentëve, të cilat përmbajnë të dhënat që nga rregjistrimi, ndjekja e studimeve deri në përfundim/diplomim të tyre.</p> <p>GVJ gjykon që mesatarja për këtë program studimi është e ulët prandaj sugjerohet që të bëhen më shumë përpjekje në promovimin e programit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" për të rritur shanset e tërheqjes së studentëve me mesatare më të lartë.</p> <p><i>Tabela 21 Cilesia ne hyrje dhe ne dalje e studenteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit. Që në fazën e regjistrimit institucioni rregjistron të dhënat fillestare të studentit dhe më pas e plotëson atë me informacionin në vijimësi. Për sa i përket diplomimit dhe punësimit eventual të të diplomuarve në programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" nuk ka ende student të diplomuar pasi brezi i parë i fillimit të studimeve i përket vitit akademik 2018-2019, të cilët diplomohen në vitin akademik 2019-2020.</p> <p><i>Evidenca 95 FE Rregullore e Sekretarisë.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve mbahen në mënyrë elektronike si edhe manuale nga sekretaria mësimore.</p> <p>Nota e provimit hidhet në sistem nga pedagogu i lëndës i cili gjithashtu plotëson edhe procesverbalin e provimit që dorëzohet i firmosur në</p>

sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	sekretari. Sekretaria mësimore ruan dhe arshivon procesverbalet e provimit duke i hedhur notat në rregjistër. Të dhënat janë të sigurta dhe të verifikueshme lehtësisht nga personat e autorizuar në nivel institucional në rast verifikimi apo kontrolli.  <i>Evidenca 95 FE Rregullore e Sekretarisë.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Programi me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" ka brezin e parë të studentëve në vitin akademik 2018-2019 të cilët diplomohen në vitin akademik 2019-2020, për këtë arsye nuk ka të dhëna për shkallën e cilësisë së punësimit të tyre.  GVJ sygjeroi në të ardhmen rishikimin e planit mësimor me qëllim përmirësimin e tij duke ju referuar një feed back-u të marrë nga studentët që do të diplomohen por edhe programeve të njëjta apo të ngjashme në nivel ndërkombëtar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të UMT ( <i>Evidenca 12</i> ) sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Ata janë anëtar me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik.  Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: <ul style="list-style-type: none"><li>- -Senatin Akademik të UMT;</li><li>- NJBSC</li></ul> <i>Evidenca 12 UMT Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UMT garanton lirinë e dhënies së mendimeve apo sygjërimeve të studentëve në lidhje me vlerësimin e procesit akademik. Në fund të çdo semestri, në përfundim të çdo lënde, student npm një pyetësori japin mendimet e tyre në lidhje me performancën e çdo pedagogu, për mësimdhënien në leksione, seminare, komunikimin etj ( <i>Evidenca 11</i> ). Vlerësimi nga studentët mbetet anonim dhe i gjithë informacioni i dhënë prej tyre është konfidencial.  Gjithashtu gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik, me student dhe me përgjegjësën e departamentit, u evidentua se në raste ankesash apo problematikash, studentët pasi e parashtrajnë situatën npm email-it, brenda 48 orësh marrin jo vetëm përgjigje zyrtare por edhe zgjidhje për

	<p>situatën (<a href="#">Evidenca 127</a>).</p> <p><a href="#">Evidenca 11 UMT Model i pyetësorit për studentët.</a></p> <p><a href="#">Evidenca 127 FE Shembull Ankimim note.</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi I studimit sikurse edhe programet e tjera të ofruar nga institucioni, mbajnë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studentit, mbështetur kjo në rregulloren e institucionit dhe rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Bazuar në rregulloren e UMT (<a href="#">Evidenca 2</a>) dhe rregulloren e programit të studimit (<a href="#">Evidenca 58</a>) me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente", lejohen transferimet nga profile të njëjta apo të ngjashme.</p> <p>Në takimin që GVJ pati me stafin akademik dhe me përgjegjësën e departamentit, GVJ rekomandoi rishikimin e planit mësimor duke ju referuar programeve të njëjta apo të ngjashme të ofruara nga institucione të arsimit të lartë në vend apo jashtë (<a href="#">Evidenca 39</a>). Gjithashtu GVJ rekomandoi përmirësimin e planit mësimor duke shtuar më tepër lëndë me specifika të turizmit, hotelerisë dhe shërbimit.</p> <p><a href="#">Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</a></p> <p><a href="#">Evidenca 58 Rregullore e programit</a></p> <p><a href="#">Evidenca 30 UMT Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde, studentët japin opinionet e tyre në lidhje me stafin akademik dhe mësimdhënien. Në takimin me stafin akademik GVJ evidentoi se edhe përmbajtja e ngarkesa e lëndëve sipas veprimtarive formuese përshtateshin me nivelin e studentëve sikurse edhe me profilin e programit të studimit. Kështu në shumë lëndë seminarët trajtoheshin duke sjellë raste studime apo koncepte në fushën e turizmit. GVJ, gjykon se duke qene se është brezi i parë i studentëve që diplomohen, procesi i rishikimit dhe përmirësimit të programit nuk është bere.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në takimin që GVJ pati me studentët e Programit me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente", si edhe në dokumentacion (<a href="#">Tabela 15</a>) në lidhje me procesin e vlerësimit e kontrollit të dijeve, u evidentua se provimet bëhen me shkrim, të sekretuara nga sekretaria mësimore dhe hapen me barkod. Mënyra e vlerësimit bëhet e qartë që në fillimin e lëndës. Pikët e fituara gjatë semestrit për frekuentimin, seminarët, detyrat e kursit i bëhen me dije studentit në përfundim të lëndës.</p> <p>Nga studentët e programit na u bë me dije se si procedohej në rast të ankimimit të rezultatit të provimit duke ndjekur në këtë mënyrë të gjitha hallkat pedagog-dekan-komision i riprovimit. Kjo gjë evidentohet edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni (<a href="#">Evidenca 127</a>). Gjithsesi studentët pohojnë se nuk kanë ankimuar ndonjëherë rezultatin e provimit, por vetëm kanë bërë verifikim dhe rishikimin e</p>

	provimit. <i>Tabela 15 Format e kontrollit te njohurive.</i> <i>Evidenca 127 FE Shembull Ankimim note</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni është pajisur me struktura të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Njësia përgjegjëse për informimin e studentëve në UMT është Zyra e këshillimit të karrierës, Alumnit dhe Zyra e shërbimit ndaj studentëve (<i>Evidenca 77</i>).</p> <p><i>Ky sektor është përgjegjes për:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ procesin e këshillimit të karrierës;</li> <li>○ ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve;</li> <li>○ mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni;</li> <li>○ krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për zhvillimin e praktikës së studentëve;</li> <li>○ krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi punësimi për studentët;</li> <li>○ organizon aktivitete për studentët;</li> <li>○ organizon trajnime, seminare, workshop-e, etj;</li> </ul> <p>Kjo zyrë ka qene promotore e një sërë aktiviteteve sociale dhe akademike në nivel institucioni, ku të përfshitë në to kanë qenë edhe studentët e këtij programi studimi (<i>Evidenca 78</i>).</p> <p>Në takimin që GVJ pati me studentët, na u konfirmua se studentët e këtij programi studimi kanë qenë pjesë e disa aktiviteteve sociale të organizuara nga kjo zyrë si psh Dhurata për femijën me sindromin Doën etj.</p> <p>Studentët gjithashtu kanë marrë pjesë në leksionin ne hapur me temë: What we sell-What our counsumers buy. Bridging the gap for sales success, etj.</p> <p><i>Evidenca 77 FE Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT.</i> <i>Evidenca 78 FE Aktivitetet e Zyrë së Karierës.</i></p>

	<p><i>Evidenca 82 UMT Rrjeti Alumni dhe aktivitete.</i></p> <p><i>Evidenca 84 UMT Aktivitete sociale artistike për studentët e FE.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UMT kujdeset për studentët që nga momenti i regjistrimit dhe fillimit të studimeve e në vazhdim nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës sikurse edhe nëpërmjet pedagogëve të departamentit. Numri i vogël i studentëve në UMT sikurse edhe në Programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente", e bën më të lehtë komunikimin, informimin si edhe këshillimin e studentëve për programin e studimit dhe gjithçka që lidhet me procesin mësimor.</p> <p>Në takimin që GVJ pati me përfaqësues të Zyrës së këshillimit të karrierës, u theksua kujdesi që u kushtohet studentëve që në momentin e regjistrimit duke iu ofruar çdo studentit "çantën e studentit" e cila përmban një kompjuter laptop i ri i cili mund të përdoret deri në momentin e diplomimit.</p> <p>UMT kujdeset gjithashtu për të ofruar bursa për nxënësit ekselentë sikurse edhe bursa në varësi të mesatares së tyre (<i>Evidenca 83</i>). UMT ofron gjithashtu edhe bursa sociale për studentë që kanë vështirësi apo pamundësi ekonomike për të ndjekur studimet.</p> <p><i>Evidenca 83 UMT Rregullore për studentët e shkëlqyer.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>UMT kujdeset për studentët që nga momenti i regjistrimit dhe fillimit të studimeve e në vazhdim nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës sikurse edhe nëpërmjet pedagogëve të departamentit. Numri i vogël i studentëve në UMT sikurse edhe në Programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente", e bën më të lehtë komunikimin, informimin si edhe këshillimin e studentëve për programin e studimit dhe gjithçka që lidhet me procesin mësimor. Këto sektorë në bashkëpunim edhe me departamentin e menaxhimit vendosin marrëveshje të bashkëpunimit me kompani ku studentët mund të kryejnë praktikën profesionale.</p> <p><i>Evidenca 77 FE Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës (<i>Evidenca 77</i>) dhe Alumni (<i>Evidenca 82</i>) bëjnë vazhdimisht përditësime të të dhënave për të diplomuarit. Studentët e rrjetit Alumni japin opinionin e tyre në lidhje atë çfarë mund të ndryshohet apo të përmirësohet në planet mësimore sipas profilit të programeve ku ata janë diplomuar. Gjithashtu informacioni për njoftimet për vende vakante në kompani apo institucione mund të vijnë nga studentët e rrjetit Alumni, të cilat këtë informacion e shpërndajnë edhe në grupet e krijuara mes studentëve të rrjetit Alumni në mediat sociale.</p> <p>Për programin me karakter profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente", këtë vit do të jenë të diplomuarit e parë, kështu që për këtë program studimi GVJ nuk mund të evidentojë se çfarë ndodh me studentët pas diplomimit të tyre.</p> <p><i>Evidenca 77 FE Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT.</i></p>

	<i>Evidenca 82 UMT Rrjeti Alumni dhe aktivitete.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## **Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente” të Universitetit “Metropolitan Tirana”**

### **Pikat e forta dhe afirmime**

1. Infrastruktura e ofruar - UMT siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.
2. Stafit akademik i UMT është i kualifikuar, me eksperiencë dhe me ekspertizën profesionale në fushat përkatëse të mësimdhënies.
3. Pjesëmarrja e UMT në projekte dhe angazhimi i studentëve në to krijon mundësinë e kualifikimit të stafit akademik por edhe forcon frymën e bashkëpunimit midis stafit dhe studentëve.
4. Sistemi i menaxhimit të informacionit ka të integruar platforma (si psh. edu4school) që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve

### **Pika të dobta**

1. Plani mësimor përmban më tepër lëndë ekonomike dhe manaxheriale sesa ato në fushën e turizmit, hotelerisë, shërbimeve dhe eventeve.
2. Një pjesë e mirë e lëndëve kanë një nivel vështirësie të madhe, duke ju referuar mesatares se ulët në hyrje të studentëve. Kjo krijon vështirësi në mësimdhënien e disa lëndëve.
3. Mungesa e finalizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë në fushën e turizmit, hotelerisë dhe eventeve, sidomos në periudhën e covid-19, krijojnë vështirësi në kryerjen e praktikës profesionale.
4. Mungesa e literaturës për lëndët profesionale krijon vështirësi për stafin akademik për të përshtatur literaturën sipas programit të studimit.

### **Rekomandime:**

1. Të rishikohet i planit mësimor dhe të përshtatet me kërkesat e tregut duke u bazuar në kërkesat e bizneseve dhe eksperiencat e studentëve të diplomuar në këtë program studimi:
  - a) Modulet në planin mësimor duhet të jenë më tepër të orientuara drejt turizmit, hotelerisë dhe eventeve, pra duke qenë në përputhje edhe me emërtimin e programit të studimit.
  - b) Modulet duhet të jenë më tepër të orientuara në aspekte praktike, duke patur kështu të planifikuara kreditet përkatëse për projekte dhe detyra kursi.
2. Të rishikohet dokumentacioni i dosjes së praktikës mësimore dhe asaj profesionale, në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit, kontratat e praktikës, relacioni i praktikës, komisioni i vlerësimit të praktikës etj.
3. Të krijohen mundësi më të shumta për zhvillimin e praktikës dhe internship-eve, duke rritur numrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë në fushën e turizmit, hotelerisë, eventeve.
4. Rekomandohet të promovohet me tej programi i studimit, për të rritur numrin e studentëve të rregjistruar, por edhe përmirësimin e cilësisë së studentëve për këtë program studimi. Lidhja e

marrëveshjeve me shkollat profesionale dhe tërheqja e studentëve të këtyre gjimnazeve, mund të jetë një mundësi e mire për të përthithur studentë që kanë një formim paraprak për këtë program studimi.

## **Evaluation conclusions on 2 Years Professional Program in Turism Management, Hotels and Events offered by the "Metropolitan Tirana" University**

### **Strengths and affirmations**

1. Infrastructure - UMT provides sufficient and appropriate environment, which helps the development of lecturing activity. This infrastructure is adequate for the program and includes: auditoriums, seminar rooms, laboratories and library.
2. The academic staff of UMT is qualified, with experiences and professional expertise in the relevant fields of teaching.
3. The participation of UMT in projects and student engagement creates the possibility of further qualification for the academic staff and strengthens the collaboration and knowledge exchange between the staff and students.
4. UMT has a management Information system integrated with platforms (such as edu4school) that enables interactive communication and information exchange between staff and students

### **Weaknesses**

1. The curriculum contains more economic and managerial subjects than those in the field of tourism, hospitality, services and events.
2. Based on the syllabus many courses, may be considered as a high difficulty level courses, referring to the low average grades in the student entrance. This creates difficulties in teaching these subjects.
3. Lack of finalization of cooperation agreements with companies in the field of tourism, hospitality and events, especially due to covid-19, created difficulties in conducting professional practice.
4. Lack of literature for professional subjects creates difficulties for the academic staff to adapt the literature according to the study program.

### **Recommendations:**

1. It is recommended to review the curriculum and adapt it to market demands, based on the requirements of businesses and the experience of graduate students in this study program:
  - a) The modules in the curriculum should be oriented toward tourism, hospitality and events, thus being in accordance with the title of the study program.
  - b) The modules should be more practical oriented, planning relevant credits for projects and course assignments.
2. It is recommended to review of the practice files (theoretical and practical/internship) regarding the cooperation agreements, internship contracts, internship report, internship evaluation commission, etc.



3. It is recommended to create more opportunities for the development of internships and internships, increasing the number of cooperation agreements with companies in the field of tourism, hospitality, events.
4. It is recommended to further promote the study program, to increase the number of enrolled students, but also to improve the quality of students for this study program. Concluding agreements with vocational schools and attracting students from professional high schools can be a good opportunity to attract a target group with prior training in the field of tourism, hospitality and Events.

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>			X	
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>			X	
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X